

iNFOSTAT



REVISTË INFORMATIVE
INSTAT

EDITORËT

DREJTOR BOTIMI

Dr. Elsa Dhuli, Instituti i Statistikave

KRYEREDAKTOR:

Altin Xhikneli, Instituti i Statistikave

BORDI EDITORIAL

1. Helda Curma, Instituti i Statistikave
2. Majlinda Nesturi, Instituti i Statistikave
3. Altin Xhikneli, Instituti i Statistikave
4. Alma Kondi, Instituti i Statistikave
5. Ilirjana Kraja, Instituti i Statistikave
6. Eriola Karpuzi, Instituti i Statistikave

KOORDINATORE:

Dorina Rizvanolli, Instituti i Statistikave

Copyright INSTAT 2020

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

*Pikëpamjet e shprehura në këtë revistë janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Institutit të Statistikave.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

e-mail: INFOSTAT@instat.gov.al

Tel: +(355) 42222411

PËRMBAJTJA

- 5. E DREJTA E INFORMIMIT DHE MENAXHIMI I KËRKESAVE TË PËRDORUESVE**
ALTIN XHIKNELI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
MARINELA LAMÇE, INSTITUTI I STATISTIKAVE
- 13. NDIKIMI I PANDEMISË NË REGJISTRIN STATISTIKOR TË NDËRMARRJEVE**
FLUTURA RAMA, INSTITUTI I STATISTIKAVE
KOZETA HAXHILLARI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
- 23. TREGTIA NDËRKOMBËTARE E MALLRAVE DHE NDIKIMI I NDËRMARRJEVE TË HUAJA**
ALMA MARA, INSTITUTI I STATISTIKAVE
ANA KARBUNARA, INSTITUTI I STATISTIKAVE
- 33. ZHVILLIMI I PROGRAMIT PESËVJEÇAR I STATISTIKAVE ZYRTARE**
IRZA RROJI, INSTITUTI I STATISTIKAVE
SILVANA SHEHU, INSTITUTI I STATISTIKAVE
NERTILA PUPULEKU, INSTITUTI I STATISTIKAVE
- 41. TRAJTIMI I MJETEVE TË VOGLA**
INVENTARI I IMËT
ESTERINA QESJA, INSTITUTI I STATISTIKAVE
- 51. INVESTIMET INFRASTRUKTURE DHE SIGURIA NË RRUGË**
ADELINA VELO, INSTITUTI I STATISTIKAVE

E DREJTA E INFORMIMIT DHE MENAXHIMI I KËRKESAVE TË PËRDORUESVE

Altin Xhikneli¹

Marinela Lamçe²

Abstrakt

Në shoqëritë demokratike, liria e informimit është vendosur në qendër të vëmendjes, si një e drejtë themelore e njeriut. Për këtë arsye përpjekjet për ta përkufizuar dhe garantuar këtë liri janë të shumta duke miratuar një sërë ligjesh dhe aktesh ndërkombëtare.

Synimi i këtij artikulli është trajtimi teorik i ligjeve për të drejtën e informimit duke u mbështetur te menaxhimi i kërkesave të përdoruesve për informacion statistikor. Për plotësimin e këtyre kërkesave, INSTAT bazohet në Ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe rekomandimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



Fjalë kyçe:

E Drejta e Informimit; Menaxhimi i kërkesave;
Anketa e Kënaqësisë së Përdoruesve

1. Instituti i Statistikave, axhikneli@instat.gov.al

2. Instituti i Statistikave, mlamce@instat.gov.al

1. HYRJE

Ditët e sotme, çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik. Neni 23 i Kushtetutës së Shqipërisë garanton të drejtën e informimit. Realizimi i komunikimit dhe ushtrimi i së drejtës për të komunikuar është thelbi i ligjit “E drejta për informim”. Baza ligjore për respektimin e lirisë për informim janë Ligji nr. 119/2014 për të “Drejtën e Informimit”, vendimi nr. 867, datë 10.12.2014; Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008, ndryshuar me Ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me Ligjin nr. 120/2014; Ligji nr. 10279 datë 20/05/2013 për Kundërvajtjet Administrative; Ligji nr. 152 për Nëpunësin Civil, Kodi i Procedurave Administrative dhe Ligji për konsultimin publik.

E drejta për informim pasqyrohet edhe në akte ndërkombëtare, si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Një rol të rëndësishëm ka Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila interpreton Konventën në praktikë.

2. E DREJTA E INFORMIMIT NË SHQIPËRI DHE MONITORIMI I SAJ

Parimi i lirisë së informimit është një nga sfidat e integritetit që Shqipëria synon të realizojë në kuadër të angazhimeve të marra për anëtarësimin në organizmat ndërkombëtare. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ka vendosur kushte dhe detyrime për Shqipërinë, me anë të të cilave synohet mbrojtja e lirisë së informacionit nëpërmjet krijimit dhe fuqizimit të legjisllacionit kombëtar.

Ligji për të drejtën e informimit ka 6 vjet që ka hyrë në fuqi, duke sjellë një ndryshim pozitiv dhe transparencë të administratës publike. Organi që monitoron zbatueshmërinë e ligjeve për informim nga administrata publike është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka për mision garantimin e të drejtës për informim, mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe garantimin e të drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik, duke shërbyer si një mekanizëm monitorues, kontrollues dhe sanksionues.

Në përmbushje të misionit të saj, Zyra e Komisionerit ka në kompetencë zhvillimin e kuadrit ligjor, ushtrimin e kontroleve dhe inspektimeve, sanksionimin në rast të shkeljeve të konstatuara, konsolidimin e punës me grupet e interesit, me institucionet publike, subjektet private dhe konsolidimin e partneritetit të brendshëm dhe të jashtëm.

3. MENAXHIMI I KËRKESAVE TË PËRDORUESIT NGA INSTITUTI I STATISTIKAVE

E drejta për informim është një mundësi për qytetarët për të plotësuar nevojat e tyre, por edhe një mundësi për administratën për të qenë sa më afër qytetarit, duke realizuar kërkesat e shtruar prej tyre. Kjo është arritur me krijimin e strukturave të posaçme si pika kontakti (Koordinatori) dhe shkëmbimi i informacionit mes autoriteteve publike dhe publikut.

Ligji për të drejtën e informimit përcakton edhe sjelljen e nëpunësit për menaxhimin e kërkesave të përdoruesve, duke e përmirësuar atë në ofrimin e informacionit.

Nëpunësi duhet të njohë dhe të zbatojë procedurat e realizimit të kërkesave si një e drejtë e përdoruesve për respektimin e lirisë së informimit. Ligji i njej të drejtën përdoruesit që të mos detyrohet të shpjegojë motivet për të cilat kërkohet informacioni. Kështu, e drejta e çdo personi për të kërkuar informacion për dokumentet zyrtare nuk shihet e shkëputur nga detyrimi i autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar.

Në këtë kuadër, Instituti i Statistikave (INSTAT), si një autoritet publik në zbatim të ligjit “Për të Drejtën e Informimit” dhe rekomandimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka hartuar dhe ka bërë publike në faqen e internetit Programin e Transparencës. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës INSTAT ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e Ligjit për të Drejtën e Informimit. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afate kohore për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Gjithashtu, çdo tre muaj INSTAT publikon në faqen zyrtare Regjistrin e Kërkesave të Përdoruesve, duke informuar përdoruesit mbi ecurinë e kërkesave dhe afatet e kthimit të përgjigjeve.


Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, janë:

- **Format Kërkesë /Ankesë;**
- **Adresë Postare;**
- **Adresë email info@instat.gov.al;**
- **Plotësim kërkesë pranë recepsionit;**
- **Portali pyetshtetin.al;**
- **Kontakti telefonik.**

Numri i kërkesave të përdoruesve ka ardhur gjithnjë në rritje.

Nga viti 2009, INSTAT ka krijuar databazën e përdoruesve për menaxhimin e kërkesave të përdoruesve. Kjo databazë shërben për të përcaktuar dhe njohur më mirë kërkesat dhe nevojat që kanë përdoruesit për statistikën. Duke iu referuar kësaj databaze, vihet re që kërkesat e përdoruesve kanë pësuar një rritje të ndjeshme pas vitit 2012. Në vitin 2019, numri i kërkesave të përdoruesve është 918.


Figura 1: Numri i kërkesave të përdoruesve 2015 – 2019



Burimi: Databaza e përdoruesve, INSTAT

Kërkesat e përdoruesve janë të ndryshme, por statistikatat e çmimeve janë të dhënat më të kërkuara nga përdoruesit për vitin 2019.

Figura 2: Klasifikimi i numrit të kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore



Burimi: Databaza e përdoruesve, INSTAT

Të dhënat e detajuara mbi kërkesat INSTAT i publikon çdo vit në Raportin Vjetor të institucionit, të aksesuesueshëm edhe nga qytetarët në faqen zyrtare të saj.

4. PROCEDUARAT PËR MENAXHIMIN E KËRKESAVE

INSTAT siguron që pyetjet dhe kërkesat e përdoruesve të regjistrohen dhe përgjigjet të kthehen brenda afateve të përcaktuara në ligjin “Për të Drejtën e Informimit”. Këto kërkesa duhet të rishikohen rregullisht për të dhënë një kontribut në procesin e menaxhimit të cilësisë mbi gjithëpërfshirjen, pasi ato mund të tregojnë nevoja të reja apo ndryshimet që përdoruesit kanë lidhur me statistikatat. Kërkesat që vijnë të protokolluara, dorazi apo me email, dërgohen tek Sektori i Marrëdhënieve me Publikun pranë INSTAT për plotësim. Informacioni i plotësuar i dërgohet përdoruesit pasi është protokolluar. Skema e detajuar më poshtë paraqet rolin e gjithësecilit në këtë proces.

Figura 3: Skema e lëvizjes së kërkesave me protokoll





Figura 4: Skema e lëvizjes së kërkesave me email dhe telefon



5. KONKUZIONET

Hartimi i manualeve të qartë të proceseve të punës, bazuar në Ligjin “Për të Drejtën e Informimit” dhe rekomandimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sjell një menaxhim të mirë të kërkesave dhe përgjigje të shpejtë dhe në kohë për përdoruesit. Nëse përgjigja nuk është kthyer brenda afateve të përcaktuara, nëpërmjet skemës së hartuar nga INSTAT identifikohet lehtësisht problemi dhe zgjidhet në kohë. Gjithashtu, Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve shërben si informacion i dobishëm për përmirësime të mëtejshme, në mënyrë që të arrihen ato çka përdoruesi kërkon. Në këtë kuadër, INSTAT, vit pas viti, sjell përmirësime në procesin e menaxhimit të kërkesave të përdoruesve për të përmbushur sa më shumë nevojat e tyre.

Në Anketën mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të zhvillur nga INSTAT në vitin 2018, përdoruesit ishin të kënaqur me shpejtësinë e marrjes së përgjigjeve (3.44, nga 5), të kënaqur me cilësinë e përgjigjeve (3.49, nga 5) dhe me një vlerësim prej 3.66 nga 5 përdoruesit mendonin se komunikimi me punonjësit e INSTAT ishte i kënaqshëm. Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve është një mjet i rëndësishëm për të konstatuar nevojat e përdoruesve dhe integruar potencialisht reagimet e tyre.

REFERENCA

1] Anketa e Kënaqësisë së përdoruesve, INSTAT,

<http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/anketa-mbi-k%C3%ABnaq%C3%AB-sin%C3%AB-e-p%C3%ABrdoruesve/>

[2] Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

<https://www.idp.al/rreth-nesh/>

[3] Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Neni 26,

<https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/kushtetuta.pdf>

[4] Ligj Nr. 119/2014 Për Të Drejtën e Informimit

<https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/160-2014-DI.pdf>

[5] Programi i transparences, INSTAT,

<http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%C3%ABrko-t%C3%AB-dh%C3%ABna/>

[6] Raporti Vjetor, (2019), INSTAT

NDIKIMI I PANDEMISË NË REGJISTRIN STATISTIKOR TË NDËRMARRJEVE

Flutura Rama¹
Kozeta Haxhillari²

Abstrakt

Në mbarë botën biznesi po kalon një situatë të vështirë si pasojë e COVID-19. Edhe pse bizneset u rihapën, pandemia globale ende po paraqet probleme serioze.

Ndërprerja e jetës publike gjatë periudhës mars-maj 2020 paralizoi shumë biznese në vend.

Kriza e koronavirusit në Shqipëri ka prekur thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë.

Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve përmban të gjitha njësitë ligjore, ndërmarrjet dhe të gjitha njësitë lokale të tyre, aktivitetet ekonomike të të cilave kontribuojnë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB).

Qëllimi i këtij studimi është analiza krahasuese dhe identifikimi i karakteristikave të ndryshimeve të ndodhura gjatë periudhës së karantinës.

Studimi do të prezantojë rezultate dhe analiza bazuar në Burimet Administrative krahasuar me Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve, 2019. Rezultatet do të japin një informacion mbi: të dhënat në ndërprerjen e aktivitetit ekonomik, të dhëna mbi ndërmarrjet që kanë deklaruar ndryshimin e aktivitetit ekonomik, të dhëna mbi numrin e të punësuarve etj.



Fjalë kyçe:

Pandemi; Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve;
Aktivitet Ekonomik; Të punësuar

1. Instituti i Statistikave, frama@instat.gov.al
2. Instituti i Statistikave, khaxhillari@instat.gov.al



Synimi i këtij artikulli është analizimi i sjelljes së ndërmarrjes gjatë periudhës së pandemisë, e më saktësisht gjatë mbylljes 2-mujore të aktivitetit ekonomik. Analiza është fokusuar kryesisht në numrin e ndërmarrjeve të cilat gjatë periudhës së mbylljes ndryshuan statusin e tyre.

Ndërmarrja, si koncept, është kombinimi më i vogël i njësive ligjore, pra një njësi organizative e cila prodhon të mira apo shërbime dhe ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj.

Burimi i të dhënave për këtë analizë është siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sipas Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Institutit të Statistikave më datë 11.3.2015. Informacioni sigurohet dhe përpunohet në mënyrë periodike për përditësimin e Regjistrit të Ndërmarrjeve.

Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve përmban të gjitha njësitë ligjore, ndërmarrjet dhe të gjitha njësitë lokale të tyre, aktivitetet ekonomike të të cilave kontribuojnë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB).

2. PANDEMITË QË NDRYSHUAN HISTORINË

Pandemitë, epidemitë dhe viruset kanë pllakosur shoqërinë gjatë gjithë historisë së saj, dhe kanë qenë po aq të ashpra e të rrezikshme sa edhe luftrat. Një pandemi është skenari më i keq. Kur një epidemi përhapet përtej kufijve të një vendi, kjo sëmundje bëhet zyrtarisht një pandemi. Civilizimi i njerëzimit është shoqëruar gjithmonë me ekspozimin ndaj këtyre pandemive.

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë njoftoi se virusi COVID-19 ishte zyrtarisht një pandemi pasi kaloi nëpër 114 vende në tre muaj dhe infektoi mbi 118.000 njerëz.

Pas shfaqjes së rasteve të para në Shqipëri, shteti shqiptar ndërmori masat e tij duke pezulluar për periudhën mars-maj 2020 të gjitha aktivitetet të cilat vinin në risk shtimin e rasteve dhe vdekjet nga ky virus. Mbyllja dhe ndërprerja e jetës publike gjatë kësaj periudhe paralizoi shumë biznese në vend. Kriza e koronavirusit në Shqipëri ka prekur thujse të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të parët që u dëmtuan ishin sektorët që lidhen me tregtinë dhe shërbimet. Ekonomia shqiptare vinte nga një goditje e mëparshme, si tërmeti i nëntorit të vitit 2019. Një mbivendosje e këtyre dy fenomeneve u kthye në një barrë të rëndë për biznesin dhe ekonominë në tërësi.

Në këtë artikull paraqitet një analizë e situatës së biznesit dhe karakteristikave të tij gjatë periudhës së mbylljes, mars-maj 2020.

3. TË DHËNAT MBI NDËRPRERJEN E AKTIVITETIT EKONOMIK, MARS-MAJ 2020

Ndërprerja e aktivitetit ekonomik botëror deri dje mund të dukej një situatë surreale, por në kohët moderne gjithçka është e mundur. Pikërisht kjo situatë surreale u bë reale në mars të vitit 2020, me ndalimin e të gjithë zinxhirit tregtar botëror. Shqipëria, ashtu si të gjithë shtetet e tjera, paralizoi pothuajse të gjithë veprimtarinë ekonomike, përveç aktivitetit të tregëtisë së produkteve farmaceutike dhe tregtisë së produkteve ushqimore, si aktivitete bazë mbështetëse në funksion të periudhës së pandemisë. Bizneset u përballën me të ardhura të humbura dhe ndërprerje të zinxhirit të furnizimit, ndërkohë që mbylljet e fabrikave dhe masat e karantinës u përhapën në të gjithë vendin, duke kufizuar kështu lëvizjen dhe tregtinë.

Në vijim do të shqyrtojmë sjelljen e biznesit gjatë kësaj paralize fokusuar më së shumti në numrin e bizneseve të mbyllura.

3.1 Të dhëna mbi ndërprerjen e aktivitetit ekonomik

Gjatë periudhës 16 mars - 2 qershor 2020 u mbyllën apo ndërprenë përkohësisht aktivitetin ekonomik 2.108 ndërmarrje. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve ishin aktive në fund të vitit 2019 dhe vetëm 150 ndërmarrje u regjistruan dhe u mbyllën në periudhën referuese, siç shihet në tabelën 1.

Tabela 1: Ndërmarrjet e mbyllura/ fjetura

Gjithsej	Nr. Ndërmarrje
	2.108
Ndërmarrje aktive në fund të vitit 2019	1.958
Ndërmarrje të regjistruara gjatë 2020	150

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)

Tabela 2: Ndërmarrjet e mbyllura/ fjetura

Statusi	Nr. Ndërmarrje
Gjithsej	2.108
Çregjistruar	240
Kërkesë për Çregjistrim	583
Pasiv	1.285

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)

Nga 72,2 % e ndërmarrjeve të mbyllura janë persona fizikë dhe 20,9 % janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Tabela 3: Ndërmarrjet e mbyllura/ fjetura sipas formës ligjore

Forma ligjore	Nr. Ndërmarrje
Gjithsej	2.108
Fermerë	49
Person Fizik	1.521
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	441
Shoqëri Anonime	7
Administrata Publike	5
OJF, Org. ndërkombëtare	69
Shoqëri të tjera	16

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme eTatimeve (DPT)

Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta zënë 12,6 % ndaj totalit të ndërmarrjeve të mbyllura, siç paraqitet në tabelën 4.

Tabela 4: Ndërmarrjet e mbyllura/fjetura sipas pronësisë

Pronësia	Nr. Ndërmarrje
Gjithsej	2.108
Shqiptare	1.842
E Huaj	177
E Huaj+Perbashkët	89

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme eTatimeve (DPT)

Aktivitetet më të prekura, që kanë shënuar dhe numrin më të madh të mbylljeve apo mbylljeve të përkohshme, janë:

- **Tregtia me pakicë, përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave, me 23,5 %;**
- **Shërbime ushqimi dhe pije, me 15,2%.**

Grupi i prodhuesve të shërbimeve ka një peshë prej 84 % të ndërmarrjeve të mbyllura gjatë periudhës referuese (16 mars - 2 qershor 2020).


Ndërmarrjet e mbyllura janë kryesisht ndërmarrje të vogla, ku ndërmarrjet vetëm me një të punësuar zënë 75 % të totalit të ndërmarrjeve të mbyllura.

Tabela 5: Ndërmarrjet e mbyllura/fjetura sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë

Aktiviteti ekonomik	Gjithsej	Grupuar sipas numrit të të punësuarve			
		1	2-4	5-9	10+
Gjithsej	2.108	1.586	381	105	36
Prodhuesit e të mirave	340	264	51	18	7
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	99	93	2	4	
Industria	162	113	38	6	5
Ndërtimi	79	58	11	8	2
Prodhuesit e shërbimeve	1.768	1,322	330	87	29
Tregtia	659	529	108	16	6
Transporti dhe magazinimi	72	64	7	1	
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	352	231	91	25	5
Informacioni dhe komunikacioni	106	75	16	12	3
Shërbime të tjera	579	423	108	33	15

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)

Figura 1: Ndërmarrjet aktive sipas madhësisë



Qarku më i prekur është ai i Tiranës, me 44,9 % i ndjekur nga qarku Korçë dhe Durrës, siç paraqitet në tabelën 6.

Tabela 6: Ndërmarrjet e mbyllura/fjetura sipas qarqeve

Qarku	Gjithsej	
	numër	%
Gjithsej	2.108	100
Berat	50	2,4
Dibër	43	2,0
Durrës	200	9,5
Elbasan	149	7,1
Fier	109	5,2
Gjirokastrë	29	1,4
Korçë	204	9,7
Kukës	24	1,1
Lezhë	64	3,0
Shkodër	112	5,3
Tiranë	947	44,9
Vlorë	177	8,4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)

4. NDRYSHIMI I KARAKTERISTIKAVE TË NDËRMARRJEVE, MARS-MAJ 2020

Më poshtë do të analizojmë sjelljen e ndërmarrjeve në lidhje me ndryshimet në aktivitetin ekonomik të tyre. Që prej vitit 2010, në Shqipëri zbatohet klasifikimi i aktivitetit ekonomik evropian, NVE Rev.2, i cili i bën statistikatat të krahasueshme në nivelin evropian. Të dhënat për aktivitetin ekonomik grupohen bazuar në këtë klasifikim evropian.

Gjatë periudhës së marrë në studim, kanë deklaruar ndryshim të aktivitetit ekonomik afërsisht 4.000 ndërmarrje, ku 30 % e tyre kanë ndryshime të aktivitetit në seksione të ndryshme.

Tabela 7: Ndërmarrjet me aktivitet ekonomik të ndryshuar

Ndryshimet në aktivitetin ekonomik		Gjithsej	Ndryshime brenda seksionit	Ndryshime jashtë seksionit
Seksioni	Seksioni Përshkrimi			
	Gjithsej	3.789	2.535	1.254
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	19	3	16
B	Industria nxjerrëse	6	4	2
C	Industria përpunuese	280	82	198
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	2		2
E	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	15		15
F	Ndërtimi	61	20	41
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorcikletave	1.974	1.665	309
H	Transporti dhe magazinimi	279	227	52
I	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	635	376	259
J	Informacioni dhe komunikacioni	59	16	43
K	Aktivitete financiare dhe të sigurimit	32	8	24
L	Aktivitete të pasurive të paluajtshme (real estate)	22	9	13
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	54	24	30
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse	99	14	85
O	Administrim publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	14		14
P	Arsimimi	31	17	14
Q	Shëndeti dhe aktivitete të punës sociale	56	29	27
R	Arte, argëtim dhe çlodhje	38	6	32
S	Aktivitete të tjera shërbimi	113	35	78

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)

Ndërmarrjet që kanë deklaruar ndryshim të aktivitetit ekonomik janë kryesisht ndërmarrje të vogla, 78 % e tyre kanë deri në 4 të punësuar.

Tabela 8: Ndërmarrjet që kanë deklaruar ndryshim të aktivitetit ekonomik sipas madhësisë

Gjithsej	Grupuar sipas numrit të të punësuarve				
	1	2-4	5-9	10-49	50+
Në numër 3.789	1.726	1.229	382	360	92
Në përqindje 100	45,6	32,4	10,1	9,5	2,4

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme eTatimeve (DPT)

5. KONKLUZIONET

Ajo çka kuptuam gjatë mbylljes së jetës publike ishte ndikimi rrënjësor që ajo pati në ekonomi. Pikërisht, ndikimi ekonomik merr forma të ndryshme; rënie në prodhim ndërsa të punësuarit qëndrojnë në shtëpi, rënie në tregti pasi blerësit shmangin vendet e mbushura me njerëz, rënie në turizëm ndërsa udhëtarët shmangin zonat e prekura. Frika, si koncept, është një pengesë në mbarëvajtjen normale të jetës socio-ekonomike. Vetëm frika nga një pandemi mund të prodhojë kosto të konsiderueshme në jetën e individit e në ekonominë në tërësi. Të zhvillosh një jetë personale e profesionale në kushte frike ul produktivitetin e cilësinë në performancë. Eksperiencia botërore e pandemive të mëparshme do të na shërbejë për të ndërmarrë hapat e duhur në mbështetjen dhe fuqizimin e ekonomisë shqiptare. Në këtë studim, u analizua sjellja e njësive ekonomike gjatë periudhës së karantinës, si dhe karakteristikat e tyre. Në fokus ishin pikërisht ndërmarrjet që ndryshuan statusin, nga aktive në të mbyllur, gjatë kësaj periudhe. Ky ndryshim u analizua në nivel qarku. E gjithë metoda analitike e shtjelluar më lartë, praktikohet mbi prodhimin e statistikave zyrtare, si dhe në publikimin vjetor të regjistrit të ndërmarrjeve. Ajo çka dihet me siguri është që themelet e ekonomisë botërore u lëkundën për shkak të kësaj situate të re e të panjohur dhe pasojat do të vlerësohen në mënyrë më optimale në vazhdim.

REFERENCA

[1] Ligji Nr. 8957 datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme, SME” ndryshuar me Ligjin Nr. 10042 datë 22.12.2008;

[2] Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe INSTAT datë 11.3.2015;

[3] Rregullore e Këshillit EU (EEC) Nr. 177/2008 datë 20 Shkurt 2008 mbi “Ndërtimin e regjistrave të ndërmarrjeve për qëllime statistikore”;

[4] Vendim i Këshillit të Ministrave për “Për miratimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të revizionuar (Rev. 2)” Nr. 320 datë 28.5.2014;

TREGTIA NDËRKOMBËTARE E MALLRAVE DHE NDIKIMI I NDËRMARRJEVE TË HUAJA

Alma Mara¹

Ana Karbunara²

Abstrakt

Tregtia e mallrave është një tregues i rëndësishëm për të paraqitur zhvillimet e një shteti, por një vend të rëndësishëm në tregtinë e mallrave në vitet e fundit kanë zënë edhe llogaritjet e treguesve të tregtisë së mallrave, duke pasur parasysh edhe ndërmarrjet të cilat kryejnë këtë tregti, si edhe karakteristikat e këtyre ndërmarrjeve. Ky lloj informacioni është bërë publike nga Instituti i Statistikave (INSTAT) nëpërmjet disa publikimeve vjetore. Qëllimi i këtij artikulli është paraqitja më e detajuar dhe thelluar të zhvillimit të tregtisë së mallrave, si edhe ndikimit që kanë pasur ndërmarrjet me pronësi të huaj në këtë tregti. Nëpërmjet këtij artikulli do të analizojmë nëse këto ndërmarrje janë të rëndësishme në tregtinë ndërkombëtare të mallrave, sa është ndikimi i tyre në këtë tregti dhe do të nxjerrim rezultatet, duke u mbështetur në kombinimin e të dhënave të tregtisë ndërkombëtare të mallrave me Regjistrin e Ndërmarrjeve për vitin 2019. Rezultatet do të japin një informacion mbi peshën që zënë ndërmarrjet e huaja në tregtinë e mallrave në tërësi, eksporte apo importe të ndara sipas madhësisë së ndërmarrjeve, sektorëve ku ato operojnë apo pronësisë së tyre.



Fjalë kyçe:

Tregtia e mallrave; Eksporti i mallrave; Importi i mallrave; Ndërmarrjet e huaja

1. Instituti i Statistikave, amara@instat.gov.al

2. Instituti i Statistikave, akarbunara@instat.gov.al



1. HYRJE

Statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave janë tregues shumë të rëndësishëm, të cilët paraqesin zhvillimet ekonomike të një vendi, aftësinë për të plotësuar nevojat e brendshme dhe në të njëjtën kohë mundësitë konkurruese nëpër botë. Këto statistika mundësojnë që institucionet qeveritare të krijojnë politika të vlefshme dhe konkrete për tregtinë dhe zhvillimin e vendit. Ato, gjithashtu, ndihmojnë në llogaritjen e disa statistikave të tjera të rëndësishme si për shembull Produktin e Brendshëm Bruto, Bilancin e Pagesave etj. Ato japin një pamje të përgjithshme për tregtinë që kryen një vend i caktuar, duke paraqitur vlerën e mallrave të eksportuara/ importuara, produktet e eksportuara/ importuara, vendet partnere, etj. Në fillim, të gjithë këta tregues ishin të mjaftueshëm për qëllimet e sipërpërmendura, por me zhvillimet dhe ndryshimet ekonomike/politike u pa gjithmonë e më tepër nevoja për statistika të reja. Për këtë arsye filluan të analizoheshin në mënyrë më të detajuar të dhënat e grumbulluara dhe u pa mundësia e llogaritjes së këtyre statistikave duke vendosur në qendër të vëmendjes ndërmarrjet të cilat kryejnë eksportet/ importet e mallrave. Këto statistika filluan të kërkoheshin gjerësisht pasi jepnin një informacion më të plotë jo vetëm për eksportet/ importet, por edhe për ndërmarrjet të cilat kryenin tregtinë e mallrave. Ato lindën si nevojë për të analizuar dhe paraqitur ndërmarrjet që dominojnë tregun, madhësinë e ndërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve, nëse janë ndërmarrje të huaja, vendase apo me bashkëpronësi - një informacion i rëndësishëm për të analizuar mundësinë e investimeve të huaja në vend dhe për t'i promovuar ato, sektorët dominues në eksportet/ importet e mallrave, etj. Ndërmarrjet e huaja konsiderohen ndërmarrjet në të cilat aksioneri i huaj zotëron mbi 50% të aksioneve, pra është vendimmarrësi.

2. PAK HISTORI PËR ZHVILLIMET E STATISTIKAVE TË TREGTISË NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE NË SHQIPËRI

Ekonomia shqiptare para viteve '90 ka qenë një ekonomi kryesisht e mbyllur, dhe duke qenë e tillë edhe statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave nuk kanë qenë shumë të zhvilluara. Të gjitha ndërmarrjet ishin ndërmarrje në pronësi të shtetit dhe kishte një numër të kufizuar produktesh të cilat eksportohehin/ importoheshin. Të gjitha veprimtaritë tregtare ishin të kontrolluara dhe të planifikuara sipas nevojave shtetërore dhe kryheshin nga shteti, jo nga individët, pasi shteti ishte pronar i ndërmarrjeve. Pas viteve '90 ekonomia shqiptare filloi të ndryshojë. Ndërmarrjet që ishin shtetërore u blenë nga individë të ndryshëm. Me kalimin e kohës u krijuan ndërmarrje të reja private dhe ekonomia filloi të zhvillohej. Me zhvillimet dhe ndryshimet ekonomike, politike jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera të rajonit u pa mundësia e krijimit të lehtësirave për kryerjen e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për këtë u krijuan Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë. Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë të nënshkruara

nga Shqipëria janë me vendet e CEFTA-s (Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Bosnje Hercegovinë dhe Moldavinë), vendet e EFTA-s (Lihtenshtejnin, Norvegjinë, Islandën dhe Zvicrën), me Turqinë dhe marrëveshja e përkohshme e Stabilizim Asocimit ndërmjet Komunitetit Evropian e Shteteve të tij anëtare dhe Republikës së Shqipërisë. Treguesit dhe statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave filluan të shtohen e përmirësohen gjithnjë e më shumë, dhe me kalimin e viteve ato u bënë të harmonizuara dhe të krahasueshme me statistikat e vendeve të tjera të botës. Në vitin 1992 u fut për herë të parë përdorimi i Dokumentit Administrativ të Vetëm, në të cilin regjistrohen mallrat që kalojnë kufirin shqiptar. Në vitin 1995 u përdor Sistemi i Harmonizuar i mallrave për klasifikimin e mallrave që eksportoheshin/importoheshin, nomenklaturë e cila u detajua më tej në vitin 1999 kur u përdor Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave. Kjo nomenklaturë përdoret edhe sot duke u përditësuar çdo vit. Duke parë zhvillimet e mëtejshme tregtare, kërkesat e vazhdueshme për statistika më të detajuara dhe specifike, si edhe kërkesat e Eurostat për Shqipërinë për të pasur statistika bashkëkohore dhe të krahasueshme me vendet e tjera, u pa e nevojshme llogaritja e statistikave të tregtisë ndërkombëtare të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve. Për herë të parë këto të dhëna u botuan në vitin 2015 për një seri kohore 4-vjeçare (2011-2014) dhe vazhdojnë të botohen çdo vit. Gjithashtu, llogariten edhe disa tregues të tregtisë ndërkombëtare të mallrave për ndërmarrjet e huaja dhe me bashkëpronësi të huaj çdo vit.

3. BURIMET ADMINISTRATIVE DHE STATISTIKORE, METODOLOGJIA DHE VARIABLAT E PËRDORUR

3.1 Burimet e informacionit

Për llogaritjen e statistikave të tregtisë ndërkombëtare të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve të huaja janë përdorur burimet administrative dhe anketat. Statistikat e eksporteve dhe importeve të mallrave janë burime administrative të cilat grumbullohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me baza mujore. Regjistri i Ndërmarrjeve përdor burime administrative si dhe anketa për përditësimin e ndërmarrjeve me frekuencë vjetore.

3.2 Metodologjia

Për llogaritjen e këtyre statistikave bëhet lidhja ndërmjet skedarit të statistikave të eksporteve dhe importeve të mallrave me Regjistrin e Ndërmarrjeve. Meqenëse përditësimi i Regjistrit të Ndërmarrjeve është me frekuencë vjetore, të gjitha llogaritjet e treguesve bëhen në bazë vjetore.

3.3 Variablat


Eksporte quhen mallrat të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, të përpunimit pasiv, të rieksporuara për t'u nënshtruar përpunimit aktiv, të shkëmbyera (tregtuara) vetëm nga ndërmarrjet.

Importe quhen mallrat që vijnë nga një vend i tretë dhe të vendosura direkt në magazinat e ruajtjes, nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor, të shkëmbyera (tregtuara) vetëm nga ndërmarrjet. Variabla të tjerë janë ndërmarrjet me pronësi të huaj, vendet partnere, madhësia e ndërmarrjes, Nomenklatura e Aktiviteteve Ekonomike.

4. REZULTATET

Në vitin 2019, vlera e tregtisë së mallrave - vlera e eksporteve dhe importeve të mallrave - të kryera nga ndërmarrjet gjithsej ishte rreth 929 miliardë lekë. Vëllimi i tregtisë së mallrave kryer nga ndërmarrjet me pronësi të huaj ishte rreth 259 miliardë lekë ose 27,9 përqind e vëllimit tregtar të mallrave gjithsej. Vlera e eksporteve të mallrave gjithsej ishte rreth 630 miliardë lekë, ndërsa vlera e eksporteve të mallrave të kryer nga ndërmarrjet me pronësi të huaj ishte rreth 130 miliardë lekë ose 43,4 përqind e eksportit të mallrave gjithsej. Vlera e importeve të mallrave gjithsej ishte rreth 630 miliardë lekë, ndërsa vlera e importeve të mallrave të kryer nga ndërmarrjet me pronësi të huaj ishte rreth 130 miliardë lekë ose 20,6 përqind të importit të mallrave gjithsej.

Figura 1: Numri i ndërmarrjeve gjithsej dhe të huaja



Në vitin 2019, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) të cilat kanë kryer tregti të mallrave (eksport ose import të mallrave) ishin gjithsej 11.832, ndërsa ndërmarrjet e mëdha (ndërmarrjet me më shumë se 249 të punësuar) ishin gjithsej 193. Ndërmarrjet SME me pronësi të huaj ishin 1.448 ose 12,2 përqind të gjithë ndërmarrjeve NVM, të cilat kanë kryer tregti të mallrave gjatë vitit 2019. Ndërsa ndërmarrjet e mëdha me pronësi të huaj ishin 63 ose 32,6 përqind të gjithë ndërmarrjeve të mëdha, të cilat kanë kryer tregti të mallrave gjatë vitit 2019. Ndërmarrjet NVM të cilat kanë kryer vetëm eksport të mallrave gjatë vitit 2019 ishin gjithsej 3.081 dhe nga këto me pronësi të huaj ishin 621 ose 20,2 përqind të gjithë ndërmarrjeve cilat kanë kryer eksport të mallrave. Ndërsa vlera e eksporteve të kryera nga NVM ishte 179 miliardë lekë dhe rreth 37,4

përqind e zinin ndërmarrjet me pronësi të huaj. Ndërmarrjet e mëdha të cilat kanë kryer vetëm eksport të mallrave gjatë vitit 2019 ishin gjithsej 109 dhe nga këto me pronësi të huaj ishin 46 ose 42,2 përqind të gjithë ndërmarrjeve cilat kanë kryer eksport të mallrave. Ndërsa vlera e eksporteve të kryera nga ndërmarrjet e mëdha ishte 119 miliardë lekë dhe rreth 63,9 përqind e zinin ndërmarrjet me pronësi të huaj. Ndërmarrjet NVM të cilat kanë kryer vetëm import të mallrave gjatë vitit 2019 ishin gjithsej 11.172 dhe nga këto me pronësi të huaj ishin 1.350 ose 12,1 përqind të gjithë ndërmarrjeve cilat kanë kryer import të mallrave. Ndërsa vlera e importeve të kryera nga NVM ishte 491 miliardë lekë dhe rreth 17,7 përqind e zinin ndërmarrjet me pronësi të huaj. Ndërmarrjet e mëdha të cilat kanë kryer vetëm import të mallrave gjatë vitit 2019 ishin gjithsej 192 dhe nga këto me pronësi të huaj ishin 62 ose 32,3 përqind të gjithë ndërmarrjeve të cilat kanë kryer import të mallrave. Ndërsa vlera e importeve të kryera nga ndërmarrjet e mëdha ishte 138 miliardë lekë dhe rreth 42,8 përqind e zinin ndërmarrjet me pronësi të huaj.

Ndërmarrjet të cilat kanë kryer eksport të mallrave gjatë vitit 2019, në sektorin e Industrisë, ishin gjithsej 1.404 dhe nga këto me pronësi të huaj ishin 287 ose 20,4 përqind të gjithë ndërmarrjeve cilat kanë kryer eksport të mallrave në sektorin e Industrisë. Ndërsa ndërmarrjet të cilat kanë kryer vetëm import të mallrave gjatë vitit 2019 në sektorin e Tregtisë ishin gjithsej 5.535 dhe nga këto me pronësi të huaj ishin 402 ose 7,3 përqind të gjithë ndërmarrjeve të cilat kanë kryer import të mallrave në sektorin e Tregtisë.

Tabela 1: Numri i ndërmarrjeve të huaja dhe vlera e tregtisë së tyre, sipas Aktiviteteve Ekonomike (NVE)

Seksione NVE	Eksporte		Importe	
	Ndërmarrjet	Vlera (mln leke)	Ndërmarrjet	Vlera (mln leke)
A	8	653	15	892
B	28	25.198	34	9.509
C	248	90.430	290	72.616
D	7	1.123	18	8.705
E	4	75	4	166
F	24	1.851	62	2.792
G	166	8.279	402	26.966
H	6	4	27	443
I	(c)	(c)	20	295
J	10	134	36	4.282
K	9	41	16	439
L			4	15
M	14	904	62	867
N	10	210	50	199
P			(c)	(c)
Q	5	12	24	739
R	(c)	(c)	(c)	(c)
S	15	584	62	624
U	29	106	26	92
Gjithsej	586	129.602	1.160	129.648

Pjesën më të madhe të tregtisë së mallrave të ndërmarrjeve të huaja e kryejnë ndërmarrjet me pronarë nga vendet e Bashkimit Evropian. Këto ndërmarrje, gjatë vitit 2019, kanë kryer 164 miliardë lekë tregti mallrash, duke zënë rreth 63,2 përqind të tregtisë së ndërmarrjeve me pronësi të huaj. Pjesën më të madhe të tregtisë së këtyre ndërmarrjeve e zë tregtia e ndërmarrjeve me pronësi italiane me 117 miliardë lekë ose 71,1 përqind të tregtisë së kryer nga ndërmarrjet me pronësi nga BE; ndërmarrjet me pronësi greke kryen 15 miliardë tregti mallrash ose 9,3 përqind të tregtisë së kryer nga ndërmarrjet me pronësi nga BE; ndërmarrjet me pronësi gjermane kryen 12 miliardë lekë tregti mallrash ose 7,6 përqind të tregtisë së kryer nga ndërmarrjet me pronësi nga BE, etj.

Një pjesë të rëndësishme të tregtisë së mallrave të ndërmarrjeve të huaja e kryejnë ndërmarrjet të cilat kanë pronarë nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto ndërmarrje, gjatë vitit 2019, kanë kryer 6 miliardë lekë tregti mallrash duke zënë rreth 2,5 përqind të tregtisë së mallrave të ndërmarrjeve me pronësi të huaj. Nga këto ndërmarrje 4 miliardë lekë ishte tregtia e mallrave e kryer nga ndërmarrjet me pronësi kosovare ose 57,2 përqind të tregtisë së mallrave të ndërmarrjeve me pronësi nga vendet e Ballkanit Perëndimor; 1 miliardë lekë ishte tregtia e mallrave e kryer nga ndërmarrjet me pronësi serbe ose 21,3 përqind e tregtisë së mallrave të ndërmarrjeve me pronësi nga vendet e Ballkanit Perëndimor, etj. Ndërmjet ndërmarrjet me pronësi nga vendet e tjera, tregtinë më të madhe e kryejnë ndërmarrjet me pronësi turke (44 miliardë lekë), pronësi nga Kina (30 miliardë lekë) etj.

Duke analizuar eksportet e mallrave, vihet re se pjesa më e madhe e eksporteve të mallrave të ndërmarrjeve të huaja kryhet nga ndërmarrjet me pronarë nga vendet e BE-së. Gjatë vitit 2019 këto ndërmarrje kanë kryer rreth 79 miliardë lekë eksporte duke zënë rreth 61,0 përqind të eksporteve të ndërmarrjeve me pronësi të huaj. Ndërmarrjet me pronësi italiane kryejnë 63 miliardë lekë eksporte ose 80,5 përqind të eksporteve të ndërmarrjeve me pronësi nga BE; ndërmarrjet me pronësi greke kryen 6 miliardë lekë eksporte ose 8,0 përqind të eksporteve të ndërmarrjeve me pronësi nga BE; ndërmarrjet me pronësi gjermane kryen rreth 4 miliardë lekë eksporte ose 5,5 përqind të eksporteve të ndërmarrjeve me pronësi nga BE etj. Një pjesë të konsiderueshme të eksporteve të mallrave për ndërmarrjet e huaja e kryejnë ndërmarrjet të cilat kanë pronarë nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjatë vitit 2019 ato kanë kryer rreth 2 miliardë lekë eksporte mallrash duke zënë rreth 1,8 përqind të eksporteve të mallrave të ndërmarrjeve me pronësi të huaj. Nga këto ndërmarrje, rreth 2 miliardë lekë janë eksportet e mallrave nga ndërmarrjet me pronësi kosovare ose 85,9 përqind të eksporteve të mallrave të ndërmarrjeve me pronësi nga vendet e Ballkanit Perëndimor, etj. Pastaj vijnë ndërmarrjet me pronësi nga Kina (22 miliardë lekë), pronësi turke (21 miliardë lekë) etj.

Ndërmarrjet me pronarë nga vendet e BE-së kryejnë pjesën më të madhe të importeve të mallrave të ndërmarrjeve të huaja. Gjatë vitit 2019 ato kanë kryer rreth 85 miliardë lekë importe, duke zënë rreth 65,3 përqind të importeve të ndërmarrjeve me pronësi të huaj. Ndërmarrjet me pronësi italiane kryejnë 53 miliardë lekë importe ose 62,5 përqind të importeve të ndërmarrjeve me pronësi nga BE; ndërmarrjet me pronësi greke kryejnë 9 miliardë lekë importe ose 10,6 përqind të importeve të ndërmarrjeve me pronësi nga BE; ndërmarrjet me pronësi gjermane kryejnë rreth 8 miliardë lekë importe ose 9,6 përqind të importeve të ndërmarrjeve me pronësi nga BE etj. Ndërmarrjet, të cilat kanë pronarë nga vendet e Ballkanit Perëndimor, gjatë vitit 2019 kanë kryer rreth 4 miliardë lekë importe mallrash, duke zënë rreth 3,2 përqind të importeve të

mallrave të ndërmarrjeve me pronësi të huaj. Nga këto ndërmarrje, rreth 2 miliardë lekë ishin importet e mallrave nga ndërmarrjet me pronësi kosovare ose 40,9 përqind të importeve të mallrave të ndërmarrjeve me pronësi nga vendet e Ballkanit Perëndimor; rreth 1 miliardë lekë ishin importet e mallrave nga ndërmarrjet me pronësi serbe ose 33,0 përqind të importeve të mallrave të ndërmarrjeve me pronësi nga vendet e Ballkanit Perëndimor etj. Ndërmarrjet me pronësi turke kryejnë 22 miliardë lekë importe mallrash, pronësi kineze 9 miliardë lekë importe mallrash, etj.

Tabela 2: Numri i ndërmarrjeve të huaja, sipas shteteve të pronësisë (NVE)

	Tregtia e mallrave	Import	Export
Ndërmarrje të huaja	1.249	586	1.160
Vendet e BE-së	819	437	766
Nga të cilat:			
Itali	520	301	493
Greqi	120	61	108
Gjermani	55	16	51
Vendet e Ballkanit Perëndimor	156	52	138
Nga të cilat:			
Kosovë	102	37	91
Serbi	15	(c)	15
Maqedonia e Veriut	32	10	26
Vende të tjera të botës	274	97	256
Nga të cilat:			
Turqi	88	31	87
Izrael	34	13	31
Kinë	31	6	30
SHBA	27	8	24

5. KONKLUZIONE

Duke u nisur nga analiza e bërë më sipër, mund të nxjerrim si konkluzion se megjithëse për vitin 2019 ndërmarrjet e huaja zinin vetëm 10 përqind të ndërmarrjeve gjithsej, tregtia e tyre zinte rreth 28 përqind të tregtisë gjithsej. Vëmë re se ndërmarrjet eksportuese të huaja zënë një përqindje më të lartë, rreth 18 përqind të ndërmarrjeve eksportuese, krahasuar me ndërmarrjet importuese të huaja të cilat zënë rreth 10 përqind të ndërmarrjeve importuese. Kjo tendencë vihet re edhe në vlerën e tyre - ndërmarrjet e huaja eksportuese eksportojnë rreth 43 përqind të eksporteve, ndërsa ndërmarrjet e huaja importuese importojnë rreth 21 përqind të importeve.

Nisur nga madhësia e ndërmarrjes, vihet re që SME zënë pjesën më të madhe të ndërmarrjeve eksportuese ose importuese, ndërsa peshën më të madhe të vlerës së eksporteve ose importeve e zënë ndërmarrjet e mëdha.

Duke u bazuar në numrin e ndërmarrjeve, vihet re se Industria është sektori që zë pjesën më të madhe të ndërmarrjeve të huaja, kurse për importet është sektori i Tregtisë. Por duke pasur parasysh vlerën e mallrave të tregtuar, vërehet se Industria është sektori që zë pjesën më të madhe si të eksporteve të ndërmarrjeve të huaja (rreth 48 përqind të eksporteve të këtij sektori), ashtu edhe për importet duke zënë rreth 41 përqind të importeve të këtij sektori. Ndërsa Tregtia është sektori që zë rreth 16 përqind të importeve të këtij sektori.

Sipas pronësisë shohim se pjesën më të madhe të ndërmarrjeve, si në numër edhe në vlerë, e zënë ndërmarrjet me pronësi nga vendet e BE-së, jo vetëm për eksportet, por edhe importet e mallrave. Kryesisht këto ndërmarrje janë me pronësi italiane ose greke. Pas tyre peshën më të madhe të tregtisë e zënë ndërmarrjet me pronësi turke dhe kineze.

REFERENCA

- [1] <http://instat.gov.al/al/temat/tregtia-e-jashtme/tregtia-e-jashtme-e-mallrave/#tab3>
- [2] <http://instat.gov.al/al/temat/tregtia-e-jashtme/tregtia-e-jashtme-e-mallrave/#tab4>
- [3] <http://instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistri-statistikor-i-nd%C3%ABrmarrjeve/#tab4>
- [4] <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/10673142/KS-GQ-20-003-EN-N.pdf>
- [5] <https://ec.europa.eu/eurostat/web/international-trade-in-goods/data/focus-on-enterprise-characteristics-tec>

ZHVILLIMI I PROGRAMIT PESËVJEÇAR I STATISTIKAVE ZYRTARE

Irza Rroji¹

Silvana Shehu²

Nertila Pupuleku³

Abstrakt

Qëllimi i artikullit është informimi i publikut për një nga dokumentet më të rëndësishëm të INSTAT, duke u bazuar në një prej objektivave strategjikë të zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, siç është “Rritja e rolit të përdoruesve në proceset statistikore”. Synimi i artikullit është t’i vijë në ndihmë lexuesve me informacion më të detajuar mbi Programin e Statistikave Zyrtare duke ofruar një historik të programit, procesit të hartimit, përmbajtjen dhe monitorimin e tij, rolin e aktorëve të përfshirë në Sistemin Kombëtar Statistikor, si dhe risitë që do të sjellë programi i ardhshëm statistikor, me qëllim përmbushjen sa më të mirë të nevojave të përdoruesve dhe kërkesave të Eurostat.



Fjalë kyçe:

Programi pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare, Fushat prioritare, aktivitet statistikor, Sistem kombëtar statistikor, Sistemi për ndjekjen e PSZ.

1. Irza Rroji, irroji@instat.gov.al

2. Silvana Shehu, sshehu@instat.gov.al

3. Nertila Pupuleku, npupuleku@instat.gov.al



1. Hyrje

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti themelor ku pasqyrohen strategjitë, planet dhe format e veprimit që duhet të zbatohen të gjithë institucionet e përfshira në sistemin kombëtar statistikor, të ngarkuar për prodhimin e statistikave zyrtare.

Ky dokument është zhvilluar ndër vite duke iu përshtatur rolit dhe kërkesave të vendit për statistika dhe rolit të Institutit të Statistikave, si institucioni kryesor jo vetëm si përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare në vend, por edhe si institucioni përgjegjës koordinues për Kapitullin 18 “Statistikat” të *acquis communautaire*. Për këtë arsye, programet kanë synuar të jenë në përputhje me Planet Kombëtare për Integritet Evropian. .

Programi i Statistikave Zyrtare për periudhën (2007-2011) ishte dokumenti i parë i këtij lloji, i hartuar në vend pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9180, datë 05.03.2004 “Për Statistikat Zyrtare”. Dokumenti u hartua me mbështetjen e ekspertëve të huaj dhe udhëhiqej nga modele të vendeve të Bashkimit Evropian. Programi shërbente jo vetëm si dokument planifikimi për statistikatat zyrtare që do prodhoheshin gjatë kësaj periudhe, por edhe si dokument strategjik për orientimin e INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore drejt cilësisë së prodhimit statistikor sipas standardeve të parashikuara nga *acquis communautaire* për statistikatat. Ky dokument angazhonte institucionet për të furnizuar prodhuesit e statistikave zyrtare me të dhëna administrative sipas formës dhe afateve të paracaktuara si dhe përcaktonte detyrimet e prodhuesve të statistikave zyrtare për afatet e publikimit të treguesve statistikorë zyrtarë.

Programi i Statistikave Zyrtare 2012-2016 ishte dokumenti i dytë i këtij lloji. Ky dokument u përmirësua dhe u strukturua më tej në përmbajtje, në përputhje me *Eurostat’s Compendium*. Për herë të parë u përfshinë dhe nevojat për burime njerëzore sipas secilës fushë statistikore, gjë e cila ndihmoi INSTAT-in për të argumentuar nevojën për zgjerimin e numrit të punonjësve si pasojë e kërkesave gjithnjë e më rritjen për tregues.

Dokument i tretë i këtij lloji është Programi i Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021, i cili është në proces zbatimi. Risi e këtij dokumenti është se ai është i strukturuar sipas strukturës së rishikuar nga Eurostat (Compendium 2015), si dhe duke iu përshtatur ndryshimeve që pësoi në vitin 2013 ligji për statistikatat zyrtare në termat e përkufizimit të Sistemit Kombëtar Statistikor. Prodhuesit e statistikave zyrtare sipas këtij programi u cilësuan si institucionet e vetme përbërëse të Sistemit Kombëtar Statistikorë të ngarkuar të prodhojnë statistika zyrtare në Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që institucionet e tjera u cilësuan si mbështetëse të sistemit.

Miratimi i ligjit të ri 17/2018 “Për statistikatat zyrtare” solli formalizmin e hartimit të Planit Vjetor për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare. Ky standard u vendos për shkak të ndryshimeve që pësoi Rregullorja (KE) 223/2009 për statistikatat evropiane në lidhje me forcimin e sistemeve

kombëtare statistikore. Duke qenë se programet e statistikave zyrtare hartoheshin në terma afatgjatë, rregullorja ngarkonte të gjithë vendet anëtare të BE-së të nxirrnin plane vjetore në zbatim të programeve shumëvjeçare. Plan i parë vjetor i këtij lloji për vendin tonë u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2019.

Për koordinimin e punës për përgatitjen, monitorimin e zbatimit të Programit dhe përgatitjen e raporteve të ecursisë së tij, u pa e nevojshme ngritja e një njësie të veçantë në strukturën organizative të INSTAT-it. Kjo njësi ndjek dhe raporton me bazë katërmujore dhe vjetore për realizimin e aktiviteteve statistikore të parashikuara në program si dhe aktiviteteve të tjera mbështetëse për INSTAT-in.

2. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT DHE INSTRUMENTAT PËR NDJEKJEN E ZBATIMIT TË TIJ

Programi përcakton aktivitetet statistikore në përbushje të strategjisë së zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor për periudhën pesëvjeçare, duke synuar përbushjen e kërkesave të përdoruesve për statistika cilësore.

Programi aktual i statistikave zyrtare 2017-2021, siç dhe është përmendur më lart, është bazuar në strukturën e Compendium-it 2015 të Eurostatit, sipas të cilit nivelet e strukturimit janë:

Fushë prioritare/modul dhe nënmodul/aktivitet statistikor dhe nënaktivitet statistikor. Programi përmban 8 fusha prioritare, të cilat ruajnë linjën logjike të strukturës së Compendiumit si më poshtë:

Fusha prioritare 2: Drejtimi Ekonomik

Fusha prioritare 4: Performancat Ekonomike dhe Sociale

Fusha prioritare 5: Qëndrueshmëria e Mjedisit

Fusha prioritare 6: Statistikat e Ndërmarrjeve Ekonomike

Fusha prioritare 7: Njerëzit e Evropës

Fusha prioritare 8: Statistikat Sektoriale, Bujqësore, Mjedisore dhe Gjeohapsinore

Fusha prioritare 11: Statistikat Shumëqëllimore dhe Efienca e Fituar në Prodhim

Module të tjera

Secila fushë prioritare përmban një përmbledhje të statistikave kryesore që synohen të prodhohen sipas moduleve dhe nënmoduleve përkatëse, objektivat strategjik, aktivitetet zbatuese, rezultatet e pritshme nga zbatimi i aktiviteteve statistikore, tabelën e aktiviteteve statistikore të shtrira në harkun kohor 2017-2021, si dhe sipas nevojës burime njerëzore shtesë.

Me anë të këtij programi synohet formalizimi i aktiviteteve statistikore dhe afateve kohore përkatëse për realizimin e tyre, institucioneve përgjegjëse për prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare, institucioneve që ofrojnë të dhënat administrative si dhe planifikimi i burimeve njerëzore shtesë të nevojshme për zbatimin e programit, bazuar në kërkesa të mbështetura me legjislacionin në fushën e statistikave.

Agjencitë statistikore të përfshira në hartimin dhe zbatimin e Programit, përveç INSTAT, janë Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nga detyrimet që rrjedhin nga ky dokument, INSTAT duhet të prodhojë statistika në të gjithë fushat prioritare të sipërpërmendura, Banka e Shqipërisë duhet të prodhojë statistika brenda fushës prioritare 4 “Drejtimi Ekonomik dhe fushës prioritare 6 “Statistikat e Ndërmarrjeve ekonomike, ndërsa Ministria e Financave dhe Ekonomisë brenda fushës 2 “Drejtimi Ekonomik”.

Një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e Programit luajnë dhe institucionet publike dhe private, të cilat ofrojnë të dhëna administrative sipas fushave dhe moduleve të caktuara statistikore. Duke synuar rritjen e gamës së të dhënave administrative të nevojshme për prodhimin e statistikave zyrtare, por edhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitutional, INSTAT ka nënshkruar një sërë memorandumesh mirëkuptimi me institucionet që mund të ofrojnë këto të dhëna. Memorandumet, përveç shprehjes së vullnetit për bashkëpunim ndërmjet palëve, përmbajnë edhe kategoritë e të dhënave që do të transmetohen si dhe mënyrën e transmetimit të tyre.

Nga ana tjetër, Programi i shërben përmirësimit të koordinimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, ku INSTAT, si koordinator i këtij sistemi, duhet të garantojë që gjatë realizimit të aktiviteteve statistikore të gjithë prodhuesit e statistikave zyrtare të përdorin standarde, koncepte, përkufizime, klasifikime dhe metodologji statistikore të miratuara nga Kombet e Bashkuara, Eurostat-i dhe vetë legjislacioni për statistikat zyrtare në vend, në funksion të prodhimit të statistikave cilësore.

Për të monitoruar zbatimin e Programit, njësia përgjegjëse e lartpërmendur në INSTAT ndjek realizimin e aktiviteteve statistikore dhe raporton periodikisht. Për përgatitjen e raporteve katërmujore merren inputet nga agjencitë statistikore dhe drejtoritë teknike të INSTAT mbi ecurinë e aktiviteteve statistikore sipas fushave që kanë nën përgjegjësi. Në funksion të matjes sa më të mirë të performancës, raportet katërmujore paraqesin informacion të detajuar lidhur me fazat kryesore të prodhimit statistikor si; grumbullimi, përpunimi, publikimi dhe transmetimi i të të dhënave. Tregues thelbësor është realizimi në kohë dhe me cilësi i aktiviteteve statistikore. Drejtori i përgjithshëm i INSTAT, ia paraqet raportet katërmujore për shqyrtim Këshillit të Statistikave. Ndërkohë, duke qenë se INSTAT u krijua si institucion i pavarur sipas ligjit të ri për statistikat zyrtare, ka detyrimin e raportimit vjetor pranë Kuvendit të Shqipërisë. Për këtë arsye, një seksion të veçantë zë edhe përmbushja e detyrimeve të programit të statistikave zyrtare gjatë harkut kohor njëvjeçar, duke pasqyruar aktivitetet e realizuara dhe të parealizuara, të cilat shoqërohen me arsyen e mosrealizimit. Në brendësi të këtij raporti reflektohen gjithashtu iniciativat e reja statistikore që INSTAT planifikon të ndërmarrë gjatë vitit pasardhës, aspektet e menaxhimit të burimeve financiare e njerëzore, marrëdhëniet me parterët ndërkombëtarë, ecurinë e projekteve dhe masat e marra për reduktimin e risqeve të mundshme.

Megjithatë, në kushtet kur nevojat e përdoruesve dhe kërkesat e EUROSTAT janë gjithnjë e në rritje, INSTAT duhet të zhvillohet më tej në plotësimin e këtyre kërkesave. Për këtë arsye programi i ri statistikor 2022-2026 do të mbështetet plotësisht në objektivat strategjik që Sistemi Kombëtar Statistikor ka vendosur si më poshtë:

- ➔ Të plotësohet niveli i plotë i kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare;
- ➔ Të prodhohen statistika zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranura Evropiane dhe ndërkombëtare;
- ➔ Të përfshihen institucione shitesë statistika-prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare;
- ➔ Të modernizohen më tej proceset, metodat, produktet dhe shërbimet statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare;
- ➔ Të përftohet besim i lartë publik në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur¹.

Për sa më lart, programi i ri do të strukturohet duke u bazuar në katër fusha statistikore si: statistikat sociale dhe demografike; statistikat ekonomike; statistikat sektoriale; statistikat e mjedisit dhe multidomain. Bazuar në nenin 8 të ligjit të 17/2018 “Për statistikat Zyrtare” programi do të përmbajë:

- a) përshkrimin e objektivave zhvillimorë të statistikave zyrtare;
- b) përshkrimin e aktiviteteve statistikore kryesore për secilën fushë, sipas shtojcës 1, të këtij ligji, frekuencën dhe nivelin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare;
- c) institucionet përgjegjëse për furnizimin me të dhëna administrative, si dhe institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare;
- ç) analizën e burimeve financiare dhe njerëzore të nevojshme për përmbushjen e aktiviteteve;
- d) analizën e risqeve dhe problemeve të pritshme².

Për mbulimin sa më të mirë me statistika zyrtare të këtyre fushave prioritare do të shtohet dhe numri i institucioneve prodhues statistikore. Risi kjo e iniciuar nga Rekomandimi numër 1 nga Vlerësimi i Eurostat (Peer Review) i vitit 2018, si dhe nga sfidat me të cilat po përballlet Sistemi Kombëtar Statistikor, lindur nga nevoja për një set më të gjerë indikatorësh statistikore cilësorë dhe nga rritja gjithnjë e më shumë e numrit të përdoruesve.

Duke qenë se Sistemi Statistikor po zgjerohet dhe po forcohet institucionalisht, INSTAT përballlet gjithashtu me nevojën e zhvillimit të formave më efikase për menaxhimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet prodhuesve statistikore gjatë hartimit dhe ndjekjes së Programit të Statistikave Zyrtare.

Në këtë kuadër dhe në zbatim të nënobjektivit 1.1 të strategjisë së INSTAT, i cili synon prodhimin në kohë dhe me cilësi të treguesve statistikore kombëtar dhe rajonal, me mbështetjen e qeverisë suedeze, INSTAT po ndërton një sistem elektronik për planifikimin, ndjekjen dhe raportimin në kohë reale të ecurisë së aktiviteteve statistikore të planifikuara në Programin e Statistikave Zyrtare. Kjo formë raportimi do të ofrojë mundësi jo vetëm për monitorim në kohë reale, por edhe për vlerësim momental të risqeve apo problematikave që hasen në procesin e zbatimit.

1. Strategjia e Sistemit Kombëtar Statistikor 2018-2030, fq. 36.

2. Ligji 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, neni 8, fq. 5.

it të Programit, gjë që do të ndihmojë dhe lehtësojë përmbushjen cilësore të objektivave të vendosur për zbatimin e tij.

Në interes të përmirësimit të koordinimit të punës për hartimin e programit të ri dhe planit vjetor për zbatimin e tij, me marrëveshje ndërinstytucionale është krijuar edhe Komiteti i Prodhuesve të Statistikave Zyrtare. Ky komitet përbëhet nga përfaqësuesit më të lartë të INSTAT, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Komiteti do të diskutojë hap pas hapi projektdokumentin dhe do të propozojë aktivitetet statistikore prioritare, duke ndikuar jo vetë në zgjerimin e statistikave zyrtare në vend, por edhe kosto-efektivitetin si rezultat e bashkëpunimit ndërinstytucional.

3. KONKLUZION

INSTAT po fokusohet gjithnjë e më shumë drejt planifikimit strategjik të aktiviteteve statistikore, ku bazuar në nenet 7 dhe 8 të ligjit 17/2018 “Për statistikave zyrtare” parashikohet ndërtimi i një Programi të ri, në të cilin realizimi i aktiviteteve statistikore të planifikuara do të jetë në funksion të përmbushjes së strategjisë së INSTAT dhe strategjisë së Sistemit Kombëtar Statistikor. Një ndër sfidat kryesore të INSTAT për zbatimin me sukses të aktiviteteve statistikore është gjetja e mekanizmave të duhur për hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e Programit. Së shpejti, do të vihet në zbatim sistemi elektronik për raportimin e ecursisë së aktiviteteve statistikore të planifikuara sipas Programit.

Në kushtet kur procesi i Integritimit Evropian paraqet nevojën për përmbushjen sa më të mirë të kërkesave për të dhëna statistikore si dhe zgjerimin e gamës së tyre, INSTAT është i angazhuar në zhvillimin e dokumenteve strategjik, të cilët ecin në të njëjtën linjë me dinamizmin e progresit të standardeve bashkëkohore evropiane, për të siguruar përditësimin me metodologjitë dhe praktikatat më të mira statistikore të aplikuara, në përmbushje gjithnjë e më shumë të nevojave të së ardhmes.

REFERENCA

[1] Compendium 2015 i Eurostat, fq. 3-9.-.

<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/6904809/KS-GQ-15-006-EN-N.pdf/5e7ca912-8d0c-4527-8d19-a078811b8a22>

[2] Compendium 2017 i Eurostat, fq. 3-9.

<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/8196153/KS-GQ-17-009-EN-N.pdf/198ed9fd-c92a-48dd-b27c-00a6866f29d6>

[3] Ligji 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, fq. 4-5.

http://instat.gov.al/media/3987/projekt-strategjia-per-instat_31-08-2017.pdf

[4] Strategjia e Sistemit Kombëtar Statistikor 2018-2030, fq. 4-36.

<http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/ne-jemi-instat/programi-kombetar-i-statistikave-zyrtare/>

[5] Strategjia e INSTAT 2017-2030, fq. 2-5.

http://instat.gov.al/media/3987/projekt-strategjia-per-instat_31-08-2017.pdf

[6] Strategjia e Sistemit Kombëtar Statistikor 2018-2030, fq. 4-36.

TRAJTIMI I MJETEVE TË VOGLA

INVENTARI I IMËT

Esterina Qesja¹

Abstrakt

Ky artikull ka për qëllim të vlerësojë efektin e ndryshimeve metodologjike midis Sistemit European të Llogarive SELL (ESA) 95/ 2010 të elementëve të Inventarit të Imët me Standardet Kombëtare të Kontabiliteti në ekonominë shqiptare. Për të analizuar këtë efekt janë marrë në analizë informacionet nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative që disponohen në Institutin e Statistikave. Informacionet bazohen gjithashtu në kontabilitetin kombëtar, duke pasur parasysh ndryshimet e kërkuara nga Sistemi European i Llogarive (SELL/ ESA). Artikujt që kanë një lidhje logjike me “small tools” në kontabilitetin tonë kombëtar bëjnë pjesë në zërin e inventarit të imët. Përgjithësisht me inventar të imët kuptojmë “ato mjete të vogla (mjete dore) të cilat nuk kanë ndonjë vlerë ekonomike të madhe, përdoren si mjete ndihmëse në procese të ndryshme të punës apo të prodhimit, kanë një jetëgjatësi jo shumë të madhe dhe me një ndikim të vogël, por jo më pak të rëndësishëm në ekonominë e vendit”². Shpeshherë lindin dilema në përcaktimin e inventarit të imët pasi në disa raste ai klasifikohet si konsum i ndërmjetëm dhe në disa raste klasifikohet si investim. Në këtë artikull është bërë i mundur ballafaqimi i informacioneve të marra nga metodologji të ndryshme statistikore me standardet e vendosura nga kontabiliteti, në mënyrë që të arrihet një marrëveshje në klasifikimin dhe vlerësimin e duhur konform rregullave të SELL 2010. Analiza që bëhet paraqet rëndësinë e studimit të matjes së inventarit të imët, gjendjen aktuale të mbledhjes së informacionit dhe impaktin që mund të na japë në vlerësimin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB).



Fjalë kyçe:

Inventar i imët; Sistemi European i Llogarive (SELL); Sistemi i Llogarive Kombëtare (SLLK); Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK); Formimi Bruto i Kapitalit Fiks (FBKF)

1. Instituti i Statistikave, eqesja@instat.gov.al

2. “KONTABILITETI”-Koncepte, metoda dhe përdorime, 2011, Botimi i gjashtë.



1. HYRJE

Për të kuptuar më tepër rreth inventarit të imët, në fillim duhet të njihemi me termin inventar në tërësi dhe çfarë pjesë zë, ai tek inventarët. Zëri “Inventarët” kategorizohet si pjesë e Aktiveve Afatshkurtra.

Sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK4-Inventarët), me termin Inventar kuptojmë: Aktivet:

- a) e mbajtura për shitje në rrjedhën normale të njësisë ekonomike raportuese;
- b) që ndodhen në procesin e prodhimit;
- c) në formë materialeve ose furnizimesh për t’u përdorur në procesin e prodhimit ose në kryerjen e shërbimeve.

Sipas Standardit Kombëtar të Kontabilitetit (SKK5-Aktivët Afatgjata Materiale Dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale), me termin Aktivët Afatgjata Materiale (AAM) kuptojmë ato aktive materiale që:

- a) përdoren nga njësi ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për t’ua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe;
- (b) priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël.

Për të trajtuar Inventarin e Imët (mjetet e vogla) mbështetemi në informacione të marra nga burime dhe metodologji të ndryshme si SLLK 2008, SELL 1995/2010, etj. Krahasimi që bëhet nëpërmjet metodologjive dhe rregullave të kontabilitetit do na ndihmojë në analizën që do të kryhet në vazhdim.


Informacioni i nevojshëm që na duhet për të bërë vlerësimin sipas metodologjive përkatëse bëhet:

a) Për sa i përket trajtimit që bëhet në rregullat e kontabilitetit

Bilanci Kontabël përbëhet nga tre pjesë: aktivet; detyrimet dhe kapitali i pronarëve. Aktivët ndahen në Aktive Afatshkurtra dhe Aktive Afatgjata. Aktivët afatshkurtra ndahen në: aktive monetare; derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim; aktive të tjera financiare afatshkurtra; inventari; aktivët biologjike afatshkurtra; aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje; parapagimet dhe shpenzimet e shtyra.

Në zërin e katërt të aktiveve afatshkurtra përfshihet “Inventari” ku futen lëndët e para; prodhim në proces; produkte të gatshme; mallra për rishitje; parapagesat për furnizime. Lëndët e para ndahen në materiale dhe inventari i imët. Inventari i imët bën pjesë si nënë në pikën e parë (a) me nr.32 me termin “Inventari i imët dhe ambalazhet”. Figura 1 paraqet në mënyrë të qartë rrugën e klasifikimit të inventarit të imët.

Figura 1: Paraqitja skematike e klasifikimit të zërit inventar i imët¹



b) Sipas Sistemit të Llogarive Kombëtare (SLK), SNA 2008

Shpenzimet mbi prodhimin e mjeteve të vogla me vlerë të vogël monetare dhe që përdoren për të kryer operacione relativisht të thjeshta, mund të trajtohen si konsum i ndërmjetëm kur këto shpenzime janë kryer rregullisht dhe janë shumë të vogla në krahasim me shpenzimet për makineri dhe pajisje. Shembuj të këtyre mallrave janë mjete dore si sharrë, lopatë, çekiç, kaçavida dhe kështu me radhë. Megjithatë, në vendet ku mjete të tilla përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të stokut të prodhuesve të mallrave të qëndrueshme, ato mund të trajtohen si asete fikse. Formimi Bruto i Kapitalit Fiks (FBKF) përjashton disa të mira që mund të përdoren vazhdimisht, në prodhim ndër vite, por që janë shumë të vogla, të lira dhe përdoren për të kryer operacione relativisht të thjeshta. Mjetet e punës me dorë si sharra, lopata, thika, sëpata, çekiçi, kaçavida, etj., janë shembujt konkretë. Nëse shpenzimet për mjete të tilla ndodhin në një normë të qëndrueshme dhe në qoftë se vlera e tyre është e vogël në krahasim me shpenzimet për makineritë dhe pajisjet më të ndërlikuara, këto mund të jenë të përshtatshme për t'u trajtuar si mjete që përdoren si konsum i ndërmjetëm. Pak fleksibilitet është i nevojshëm, megjithatë varet nga rëndësia relative e mjeteve të tilla. Në vendet në të cilat këto mjete përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të vlerës së totalit të stokut mbi prodhimin e të mirave të qëndrueshme industriale, ato mund të trajtohen si asete fikse nga ana e prodhuesve dhe blerja e tyre apo asgjësimi mund të përfshihen nën Formimin e Kapitalit Fiks Bruto.

1. SKK2, Pasqyra financiare e miratuar nga KKK

Sistemi European i Llogarive është metodologjia kryesore që përdoret si bazë referuese në përpilimin e Llogarive Kombëtare në Shqipëri. Ndër vite kjo metodologji ndryshon dhe përditësohet. Më poshtë do të paraqitet trajtimi metodologjik i SELL 1995 dhe SELL 2010 dhe ndryshimet midis tyre.

c) Sipas Sistemit European të Llogarive SELL (ESA) 1995:

SELL 1995 tregon kufij të qartë regjistrimi, për shembull për regjistrimin e mjeteve të vogla dhe aparaturave si konsum i ndërmjetëm.

Në kap 3.70 për Konsumin Ndërmjetës thuhet:

Konsumi i ndërmjetëm përbëhet nga vlera e mallrave dhe shërbimeve të konsumuara si inpute nga një proces prodhimi, duke përjashtuar asetet fikse, konsumi i të cilave regjistrohet si konsum kapitali fiks. Mallrat dhe shërbimet mund ose të transformohen ose të përdoren në procesin e prodhimit.

Konsumi i ndërmjetëm përfshin rastet kufitare të mëposhtme ku pika (e) thekson që:

e) Objekte që nuk trajtohen si formim kapitali bruto, si:

1. mjete të vogla që nuk janë të kushtueshme dhe përdoren për përdorime të thjeshta, si sharrat, çekicët, kaçavidat dhe të tjera mjete dore; aparate të vogla si makinat llogaritëse të xhepit. Sipas konventës, në SELL, të gjitha shpenzimet për mallra të tillë të qëndrueshëm që nuk tejkalojnë 500 EURO (me çmimet e 1995) për objekt (apo, kur blihen në sasi, për gjithë shumën e blerjes), duhet të regjistrohen si konsum i ndërmjetëm;
2. mirëmbajtja, e zakonshme, e rregullt apo riparimi i aseteve fikse të përdorura në prodhim;
3. armët ushtarake të shkatërrimit dhe pajisjet e nevojshme për lëvrimin e tyre (por jo armët e lehta dhe makinat e blinduara të blera nga policia dhe forcat e sigurisë, që trajtohen si formim bruto i kapitalit fiks);
4. shërbimet e kërkim-zhvillimit, trajnimit të stafit, kërkimi i tregut dhe aktivitete të ngjashme, të blera nga një agjenci e jashtme apo të ofruara nga një KAU lokal i veçantë i të njëjtës njësi institucionale.

Ndërsa në pikën 3.108:

Formimi Bruto i Kapitalit Fiks (FBKF) përjashton:

a) transaksionet e përfshira në konsumin e ndërmjetëm, si:

1. blerjet e mjeteve të vogla për qëllime prodhuese;
2. mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme;
3. blerjet e armëve ushtarake dhe sistemeve të tyre mbështetës;

b) blerjet e aseteve fikse që do përdoren për kontrata leasingu financiar;

c) transaksionet e regjistruara si ndryshime në inventare:

1. kafshë të rritura për mish, duke përfshirë mishin e pulës;
2. drurë për lëndë drusore (punë në vazhdim).

d) makineritë dhe pajisjet e blera nga familjet për konsum final (shpenzim konsumi final);

e) fitoret dhe humbjet mazhoritare të aseteve fikse (ndryshime të tjera në asete);

- f) humbjet katastrofike të aseteve fikse (ndryshime të tjera në asete), për shembull shkatërrimi i aseteve të kultivuar dhe gjësë së gjallë nga shpërthimet e sëmundjeve (dhe që nuk mbulohen zakonisht nga sigurimet) apo dëmtimet për shkak të përmbytjeve, dëmtimeve të erës apo zjarret në pyje.

Dy lloje mallrash të qëndrueshëm të përdorura nga prodhuesit përjashtohen nga Formimi Bruto i Kapitalit Fiks (FBKF): mjete të vogla (inventari i imët) dhe tipe të caktuara pajisjesh ushtarake, prandaj nuk ka asete korresponduese. Për më tepër, pajisjet e transportit dhe makineritë, dhe pajisjet e tjera të blera nga familjet për konsum final nuk shihen si asete fikse. Ato hyjnë në pikën e memorandumit “mallrat konsumatore” në bilanc.

b) Sipas Sistemit European të Llogarive SELL (ESA) 2010

SELL 2010 e trajton ndryshe inventarin e imët.

Në trajtimin që bëhet në SELL 2010 nuk është dhënë ndonjë kufi fiks; kriteri për t'u njohur si shpenzim kapitali është përdorimi në prodhim për më shumë se një vit apo periudhë ushtrimore. Në praktikë, artikujt e njohur si mjetet me vlerë të vogël monetare të përdorura për procese të përbashkëta, të tilla si sharra, lopata, thika, sëpatë, çekiçi, kaçavida, mjete të tjera dore, pajisje të vogla të tilla si llogaritës xhepi, janë regjistruar si konsum ndërmjetës.

Ndryshe nga SELL 95 e cila ka vendosur kufirin më të ulët prej 500 EURO për mjetet e vogla që të njihen si shpenzime kapitale, SELL 2010 ka vendosur si mënyrë klasifikimi vetëm kriterin e periudhës së përdorimit të këtyre mjeteve për më shumë se një vit.

2. ANALIZË

Sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, instrumentët përbërës të inventarit trajtohen si aktive afatshkurtra pavarësisht vlerës ekonomike që kanë dhe jetëgjatësisë së afatshkurtër. Në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit përshkruhen si aktive afatshkurtra të gjitha aktivet e njësish ekonomike që ndikojnë në sigurimin e përfitimeve ekonomike të njësish në një afat të shkurtër kohor, zakonisht më pak se një vit (prandaj shpesh quhen aktive qarkulluese).

Ndërkohë, sipas botimit të gjashtë të librit “Kontabiliteti (Koncepte, Metoda dhe Përdorime)”, inventari i imët përfshihet në zërin e Inventarit. Mjetet e vogla janë objekte të cilat kanë karakteristika të aktiveve afatgjata (përdorim mbi një vit), por duke qenë se kanë vlerë të vogël monetare përfshihen tek inventarët si:

- Ambalazhi i kthyeshëm (arka, fuçi, etj)
- Inventari i imët (pinca, sharra, mushama, etj.)

Pra mjetet e vogla ose ndryshe të ashtuquajturat inventar i imët mund të shihen edhe si aktive afatgjata materiale. Me aktive afatgjata materiale kuptojmë elementë të aktivitetit të pasurisë që:

- Kanë substancë ose formë fizike
- Kohëzgjatja e përdorimit parashikohet dhe llogaritet për më shumë se një periudhë ushtrimore
- Konsumohen gradualisht (pjesë-pjesë) dhe rëndojnë koston e prodhimit (shërbimit) për pjesën e konsumuar

- Ruajnë formën fillestare
- Kanë vlerë mbi 5.000 lekë (45 euro)

Për të pasur më të qartë trajtimin e inventarëve të imët japim një shembull.

Pjesët e këmbimit klasifikohen gjithmonë si inventar i imët. Për shembull, në rastin e një hidrocentrali artikuj si kuzhineta, kompresorë, manometër etj., klasifikohen në inventarin e shoqërisë. Megjithatë, pjesë të mëdha këmbimi klasifikohen si aktive afatgjata materiale nëse njësia ekonomike parashikon t'i përdorë ato për periudha kohore më të gjata se një vit. Në mënyrë të ngjashme, nëse pjesët e këmbimit i vendosen një aktivi afatgjatë material, si për shembull pompat e ujit, vajit apo nyjet e ftohjes së gjeneratorëve në rastin e një hidrocentrali, në momentin e përdorimit këto pjesë këmbimi duhet të riklasifikohen edhe vetë si aktive afatgjata materiale dhe do të amortizohen të veçanta sipas jetëgjatësisë së tyre.

3. KONKLUZIONET

Sipas analizës, në rastet kur përdoret SELL 95, kufizohet në vlerën nën 500 euro për përcaktimin e inventarit të imët si konsum ndërmjetës, por sipas SELL 2010 nuk ka kufij monetarë përcaktimi, pra mjafton vetëm periudha e përdorimit në prodhim mbi një vit, prandaj duke u bazuar dhe në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit një pjesë e instrumenteve të inventarit të imët si uniformat, çizmet e punëtorëve, çekiçët, pinca, etj., të cilat kanë jetëgjatësi më shumë se një vit, por zënë një hapësirë jo të konsiderueshme financiare, nuk përfshihen më si konsum ndërmjetës, por si investim në FBKF. Efektet në ndryshimin e PBB-së sipas SELL-ve të ndryshme kanë të gjitha investimet me vlerë nga 1 deri në 500 euro. Për një analizë sa më të saktë janë marrë në studim dy intervale të dhënash, përfshirë këtu edhe vlera e parashikuar në kontabilitetin kombëtar: Intervali i parë nga 1 deri në 45 euro dhe Intervali i dytë nga 45 deri në 500 euro.

Sipas përditësimit të SELL 2010 dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, elementët e përfshirë në intervalin me vlerë monetare nga 45 deri në 500 euro duhet të përfshihen në FBKF. Të gjithë artikujt me vlerë mbi 45 euro përfshihen si investime afatgjata materiale në kontabilitetin e njësive ekonomike. Pra, me ndryshimin e metodologjisë kërkesat e SELL 2010 përputhen me standardet e kontabilitetit. FBKF aktuale për këtë interval është konform rregullave të SELL 2010, pra mund të themi se SELL 2010 ka të njëjtin definicion me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Mjetet e vogla tashmë konsiderohen si investime, kufiri i të cilave është më shumë se një vit dhe me një vlerë mbi 45 euro, siç shihet në figurën 2.


Intervali me vlerë monetare nga 1 deri në 45 euro përfshin një analizë më të thelluar, pasi kërkesat e përcaktuara në SELL 2010 nuk janë në përputhje me parashikimet e standardeve të kontabilitetit. Njësitë ekonomike kanë dorë të lirë të përcaktojnë nëse këto mjete të vogla të përfshihen në shpenzime të periudhës e të mbahen në një regjistër të jashtëm, apo të regjistrohen në inventarin e imët. SELL 2010 nga ana tjetër kërkon që këto mjete të vogla të përfshihen detyrimisht në FBKF pasi periudha e përdorimit të tyre është mbi një vit. Vlera totale e këtyre mjeteve të vogla nën 45 EUR në krahasim me totalin e mjeteve nga 45 deri në 500 EUR mund të themi që ka një impakt të vogël në vlerësimin e PBB-së, siç shihet në figurën 2.

3.1 Pasojat e ndryshimit të 2 SELL-ve dhe ndikimi në PBB

Për momentin, zëri inventar i imët nuk përfshihet në mënyrë direkte në vlerësimin e PBB-së (metoda e prodhimit). Është e mundur që në të ardhmen të ketë një efekt të vogël në zërin e FBKF dhe konsumit të ndërmjetëm në PBB. Ndryshimi në vlerën e shtuar është rrjedhojë e ndryshimit në konsumin e ndërmjetëm (metoda e prodhimit) dhe e barabartë me ndryshimin në formimin bruto të kapitalit fiks (metoda e shpenzimeve) dhe në tepricën operative bruto (metoda e të ardhurave).

Figura 2 paraqet në mënyrë praktike dhe të kuptueshme analizën e realizuar më lart, duke përdorur të gjitha kriteret e vendosura nga metodologjitë e marra në konsideratë për të kryer këtë skemë.

Figura 2: Paraqitja skematike e Analizës mbi Mjetet e vogla (Inventari i Imët):



Për sa i përket *mundësisë praktike*, në vendin tonë kompanitë të cilat deklarojnë në pasqyrat financiare të tyre inventarin e imët janë të rralla. Edhe në rastet kur deklarohen, nuk ka një trajtim të qartë të elementëve që përfshihen në zërin inventar i imët për sa i përket vlerës dhe jetëgjatësisë së tyre.

Edhe nëse ndonjë kompani deklaron inventarin e imët, vlera e këtyre zërave është shumë e vogël dhe pesha që zënë në FBKF dhe në ekonominë e Shqipërisë në tërësi është pothuajse e papërfillshme.

Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN) nuk e mbulon në mënyrë direkte këtë pjesë si informacion. Por vitet e fundit (2018-2019) është zhvilluar një anketë e re, Prodcum, e cila është akoma në përmirësim.

Anketa Prodcom ka si objekt vrojtimi ndërmarrjet që kanë kryer aktivitet ekonomik gjatë vitit të cilit i referohet dhe që i përkasin sektorëve industri nxjerrëse dhe industri përpunuese, të paraqitura sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Statistikat e Prodcom mundësojnë informacion mbi ecurinë e prodhimit dhe shitjes së produkteve industriale në ndërmarrjet e marra në vrojtim. Produktet e anketës detajohen në nivel 6-shifror prandaj në këtë anketë të dhënat mbi inventarët janë më të detajuara. Anketa mbledh informacion mbi llojin e produkteve që prodhon/ përpunon ndërmarrja, njësinë e matjes, inventarin në fillim të vitit, prodhimin në sasi gjatë vitit, inventarin në fund të vitit, dhe shitjet gjatë vitit në sasi dhe në vlerë.

Për sa i përket faktit se çfarë mund të bëhet në të ardhmen, ne mund të studiojmë ecurinë e treguesve të inventarit të imët me qëllim vlerësimin e peshës specifike të këtij zëri në inventarin e njësive ekonomike. Në këtë mënyrë, mund të arrijmë një vlerësim më të përshtatshëm të FBKF të formuar nga elementët me jetëgjatësi mbi 1 vit, por me një vlerë mbi 45 EUR.

Shoqëritë e ndërtimit dhe ato në sektorin elektronik raportojnë më shumë të dhëna për sa i përket këtij treguesi. Që ky vlerësim të realizohet në aspektin praktik dhe jo vetëm nga ana teorike, mund të themi që në të ardhmen mund të përfshihen të dhënat e marra nga anketa Prodcom për sektorët industri nxjerrëse dhe industri përpunuese, të paraqitura sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2.

Ky propozim bëhet për të studiuar efektin dhe peshën që zë "Inventari i imët" në zërin Inventari. Gjithashtu, më vonë mund të shihet dhe analiza kosto-efektivitet e këtij studimi për të bërë krahasimin e kostove dhe përfitimeve, nëse nëpërmjet kësaj ankete mund të arrijmë të kemi rezultate konkrete dhe të plotësojmë kriterin e përcaktuar nga SELL 2010. Në këtë mënyrë reduktohet edhe barra pranë njësive ekonomike, duke qenë se eliminohet nevoja për të realizuar anketa të tjera për këtë qëllim specifik.

REFERENCA

- [1] Binaj, A. & Kalemi, F. (2011). Botimi i gjashtë, “KONTABILITETI”-Koncepte, metoda dhe përdorime
- [2] Dhamo, S. & Lati, L. & Husi, B. “KKK, ‘Rregullore’: Pasqyrat Financiare dhe mënyra e plotësimit të tyre”
- [3] EUROSTAT, Manual on the Changes between ESA 95 and ESA 2010:
<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/5936825/KS-GK-14-002-EN-N.pdf-f/059d43eb-2047-40c3-9cdd-d847bfbce33b>;
- [4] EUROSTAT ,European system of accounts ESA 2010:
https://ec.europa.eu/eurostat/cache/metadata/Annexes/nasa_10_f_esms_an1.pdf;
- [5] EUROSTAT ,European system of accounts ESA 1995:
<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/5826305/CA-15-96-001-EN.pdf/aeec2852-bed2-46d2-9534-5859d3c911d5>;
- [6] Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara, SKK 4 “INVENTARËT”:
<http://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/SKK%20nentor%202015/04.%20SKK%204.pdf>;
- [7] Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara, SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”:
<http://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/SKK%205.pdf>
- [8] Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara, SKK 2 “Paraqitja e pasqyrave financiare”:
<http://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=136&gj=sh>;
- [9] Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar:
<http://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=135&gj=sh>
- [10] System of National Accounts 2008 SNA:
<https://unstats.un.org/unsd/nationalaccount/docs/SNA2008.pdf>;

INVESTIMET INFRASTRUKTURE DHE SIGURIA NË RRUGË

Adelina Velo¹

Abstrakt

Investimet për ndërtimin e rrugëve të reja dhe në mirëmbajtjen e rrugëve aktuale janë të domosdoshme për një rritje ekonomike më të lartë dhe për një lëvizje më të lehtë të pasagjerëve. Fokusi i vendosur në rritjen e aktivitetit ekonomik dhe lehtësimit të lëvizjes së pasagjerëve, ndikon në rritjen e trafikut në infrastrukturën rrugore. Nga ana tjetër përmirësimi i kushteve të infrastrukturës ndikon në uljen e aksidenteve që vijnë si pasojë e gjendjes së rrugës. Lidhur me këto dy mundësi, lind pyetja nëse rritja e investimeve në infrastrukturë, ndikon pozitivisht apo negativisht në sigurinë e lëvizjes së automjeteve dhe numrit të aksidenteve të ndodhura gjatë vitit korent. Duke u nisur nga pyetja e ngritur, qëllimi i këtij artikulli bazohet pikërisht në analizën e treguesve kryesor të shpenzimeve për infrastrukturën dhe aksidentet rrugore për të paraqitur ndikimin e investimeve në sigurinë rrugore. Përpos investimeve të reja dhe shpenzimeve të mirëmbajtjes së rrugëve në total, është e rëndësishme që analiza të fokusohet dhe në detajimet e dy treguesve kryesor sipas kategorisë së rrugëve apo dhe kushteve të motit në të cilat kanë ndodhur mjetet duke qënë se teori të shumta e bazojnë numrin e aksidenteve jo vetëm si pasojë e infrastrukturës por dhe të shumë faktorëve të tjerë mjedisor. Metodologjia e ndjekur për këtë punim është përshkruese dhe analitike e të dhënave të marra në shqyrtim duke analizuar lidhjen e korrelacionit midis treguesve duke pare marrëdhënien dhe fortësinë e lidhjes së tyre.



Fjalë kyçe:

Aksidente rrugore, Investime
infrastrukturore, Shpenzime mirëmbajtje.

1. Instituti i Statistikave, avelo@instat.gov.al



1. HYRJË

Aksidentet rrugore ndodhin për shkak të tre faktorëve kryesorë; faktori njerëzor ku përfshihen drejtimi në gjendje të dehur, mosrespektimi i rregullave të qarkullimit etj, faktori mjedisor si kushtet mjedisore dhe faktori fizik ku përfshihen kushtet e infrastrukturës (DeAngelo,G,2014). Ky artikull do të analizojë në mënyrë empirike dhe analitike ndikimin e investimeve në infrastrukturën rrugore ndaj numrit të aksidenteve të ndodhura në rrjetin rrugor. Efekti që numri i aksidenteve jep në humbje, jo vetëm materiale, por më tepër në atë njerëzore, e bën që politikat e shtetit t'i japin një rëndësi të veçantë kësaj teme, duke zënë një pjesë të rëndësishme të buxhetit të planifikuar vjetor.

Studime të shumta janë kryer në lidhje me efektin që mund të ketë ndërtimi i një segmenti të ri ose përmirësimi i atij ekzistues në numrin e aksidenteve dhe si rezultat në numrin e të aksidentuarve. Friestrom dhe Ingebrigsten (1991) dhe Karlaftis dhe Tarko (1998) arrijnë në konkluzionin që zgjatimet e rrjetit rrugor rritin numrin e përplasjeve dhe vdekjeve.

Në një përfundim të njëjtë kanë mbërritur edhe Milton dhe Mannering (1996) të cilët shprehen se rritja e numrit të korsive do të ndikojë në rritjen e numrit të përplasjeve, ndërsa korsitë e ngushta reduktojnë numrin e përplasjeve. Qasje të tillë sugjeron edhe studimi i kryer nga Noland (2003) në vijim të studimit të mëparshëm në vitin 2001. Në studimin e tij ai ka analizuar nëse përmes infrastrukturës rrugore dhe kushteve të saj rezultojnë ose jo në reduktim të vdekjeve dhe plagosjeve. Ai ka përdorur variablin “gjerësia e korsisë në milje” si një variabël proxy i përmirësimeve rrugore. Gjithashtu, ai ka analizuar të dhëna në seri kohore “cross-sectional” për regresionin me efektet fikse negative binomial për analizimin e impaktit të variablave të infrastrukturës. Nëpërmjet kësaj metode, Noland ka analizuar edhe variablat e tjerë të përfshirë në analizë. Rezultati i tij sugjeron se ndryshimet në infrastrukturën e autostradës përgjatë periudhës 1984 dhe 1997 nuk kanë reduktuar numrin e vdekjeve dhe të plagosurve, përkundrazi ka ndikuar në rritje. Ai i vë rëndësi variablave të tjerë ekzogjenë të përfshirë në model. Këto janë disa qasje të cilat nuk mbështesin idenë se politikat e fokusuar në rritjen e investimeve për të zgjeruar rrjetin rrugor do të kenë një efekt pozitiv në reduktimin e numrit të aksidenteve.

Disa analiza janë zhvilluar në nivel mikro, duke u fokusuar vetëm në një segment të caktuar rrugor dhe numrin e aksidenteve të ndodhura në po këtë aks rrugor në një seri kohore të caktuar. Gonzalez (2015) e ka fokusuar analizën e saj në këtë qasje, duke kryer një metodë eksperimentale për të vlerësuar efektin e një politike infrastrukturore të caktuar për një segment rrugor në një autostradë në Spanjë. Segmenti rrugor i marrë në analizë është ndarë si një variabël binar për pjesën e përfunduar dhe atë të papërfunduar. Rëndësi në model i është dhënë futja e sistemit të pikëve në patenta. Nga analiza është vënë re se pjesa e autostradës ku kanë përfunduar punimet, ul numrin e aksidenteve në krahasim me pjesën e papërfunduar.

Ndryshe nga dy rastet e mëparshme që mbështesin lidhjen e ngushtë të investimeve në rrugë me numrin e aksidenteve të ndodhura, Osun (2016) del në konkluzionin se në numrin e aksidenteve ndikojnë shumë faktorë të tjerë përveç investimeve në infrastrukturë. Ai analizon të dhënat për periudhën 1997-2014. Analiza është e ndarë për dy lloje rrugësh: autostradën dhe rrugët lokale. Sipas tij, përfundimi rezultoi i parëndësishëm statistikisht jo vetëm për autostradën, por edhe për rrugët lokale, duke mos e lidhur numrit e aksidenteve drejtëpërdrejt.


2. TË DHËNAT

Për të dhënë një panoramë sa më të saktë në lidhje me marrëdhënien midis investimeve rrugore dhe sigurisë në rrugë, janë marrë në shqyrtim disa variabla. Treguesit kryesorë mbi investimet rrugore dhe sigurinë rrugore janë si më poshtë:

- **Inventimet infrastrukturore**
- **Numri i aksidenteve me pasoja**
- **Aksidente të ndodhura si pasojë e kushteve të rrugës**
- **Aksidentet rrugore për 1.000 mjete rrugore**

Grafiku 1 paraqet investimet në total për infrastrukturën rrugore, duke përfshirë zërat si shpenzimet për ndërtimin e rrugëve të reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese, dhe shpenzimet për mirëmbajtjen e rrugëve në gjendje pune (shpenzimet operative).

Grafiku 1: Investimet infrastrukturore për rrugë të reja dhe ekzistuese, 2011-2018



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit


Bazuar në analizën e kryer mbi “Modifikimin e infrastrukturës rrugore për rritjen e sigurisë në rrugë në Uganda” (Friday 2012) si dhe në metodologjinë e ofruar nga Wooldridge (2003), për të analizuar marrëdhënien e investimeve infrastrukturore me aksidentet rrugore në frekuencë vjetore për periudhën 2011-2018 është përdorur koeficienti i korrelacionit Pearson. Duke përdorur koeficientin e korrelacionit Pearson, janë marrë në konsideratë dy tregues; Për variablin përfaqësues për investimet infrastrukturore është marrë logaritmi i investimeve infrastrukturore, duke qenë se ky tregues është i shprehur në njësi shumë të madhe në krahasim

me numrin e aksidenteve. Treguesi në lidhje me aksidentet rrugore është numri i aksidenteve me pasojë gjithsej të ndodhura në vit.

Nga përlogaritja e koeficientit Pearson, rezulton një marrëdhënie negative por kjo marrëdhënie shprehet e dobët midis dy treguesve të marrë në shqyrtim me një vlerë -0,1. Kjo fortësi paraqitet e dobët, duke qenë se në numrin gjithsej të aksidenteve të ndodhura në vend mund të ndikojnë një sërë faktorësh të tjerë.

Duke marrë parasysh faktorët ndikues të aksidenteve, një faktorë shumë i rëndësishëm paraqitet dhe ai fizik që përcakton kushtet e infrastrukturës. Në grafikun e dytë paraqitet struktura e aksidenteve sipas kushteve të infrastrukturës rrugore ku ka ndodhur aksidenti rrugor.

Grafiku 2: Aksidentet dhe kushtet e ndodhjes së tyre




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Vihet re që numri më i lartë i aksidenteve të ndodhura paraqitet në rrugët me kushte premtuese, ndërkohë që në rrugët me gropa, valëzime, rrëshqitje dhe pluhur, ky numër është më i ulët. Në vitin 2017, përqindja e aksidenteve të ndodhura në rrugë me kushte premtuese ndaj numrit gjithsej të aksidenteve të ndodhura në këtë vit, rezulton më e lartë përgjatë periudhës së marrë në shqyrtim me 94,8 %. Ndërkohë në vitin 2013 paraqitet përqindja më e ulët gjatë kësaj periudhe e aksidenteve të ndodhura në rrugë me kushte premtuese me 89,9 %. Si pasojë, përqindja e aksidenteve të ndodhura në kushte jopremtuese paraqitet më e lartë në vitin 2013 me 10,1 %. Kjo shpjegohet dhe me faktin e lëvizjes së automjeteve me shpejtësi të reduktuar në grupin e rrugëve me kushte jopremtuese. Për të paraqitur një pamje më të qartë të aksidenteve sipas kushteve të rrugës në periudhën kohore të marrë në shqyrtim, përlogaritet koeficienti i korrelacionit Pearson bazuar dhe në analizën e kryer mbi “Modifikimin e infrastrukturës rrugore për rritjen e sigurisë në rrugë në Uganda”, midis numrit të aksidenteve të ndodhura në vit me aksidentet e ndodhura në kushte jopremtuese. Koeficienti i korrelacionit për këtë variabël rezulton 0,2, duke paraqitur një marrëdhënie të dobët, por pozitive midis dy treguesve të marrë në shqyrtim.

E rëndësishme për t'u kuptuar në këtë pikë përse numri i aksidenteve shfaqet për një kategori rruge me një trend jokonstant është përfshirja e numrit të automjeteve në lëvizje, duke qenë se numri i aksidenteve më të mëdha ndodh në kushtet e rrugës premtuese. Është bërë përlogaritja e numrit të aksidenteve të ndodhura për 1.000 mjete çdo vit dhe grafiku i tretë paraqet trendin:

Grafiku 3: Aksidentet rrugore për 1.000 mjete rrugore, 2011-2018



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritje të autorit.

Ky tregues ka qenë 4,6 aksidente për 1.000 mjete rrugore në vitin 2011, duke u rritur me 0,1 aksidente për 1.000 mjete në vitin 2012 dhe 2013, ndërkohë në vitet në vijim ky tregues ka pësuar rënie duke arritur në 3 aksidente për 1.000 mjete rrugore. Kjo tregon se ndryshimi i numrit të mjeteve nuk ka ndikuar në numrin e aksidenteve rrugore pasi rënia e numrit të aksidenteve nga njëri vit në tjetrin është më e madhe sesa rritja e mjeteve rrugore. Gjithashtu, e shprehur nëpërmjet koeficientit të korrelacionit Pearson, lidhja midis këtyre dy variablave është e dobët dhe negative (-0,1). Bazuar në të dhënat për vendet e Bashkimit Evropian (BE) mbi aksidentet me pasoja dhe numrin e mjeteve për vitin 2018, rezulton 3,3 aksidente për 1.000 mjete rrugore. Krahasuar me situatën e vendeve të anëtarësuara në BE, situata e Shqipërisë paraqitet pozitive me një numër aksidentesh për 1.000 mjete rrugore me 0,3 aksidente për 1.000 mjete rrugore më pak.

3. KONKLuzionET

Investimet në infrastrukturën rrugore zënë një pjesë të rëndësishme në buxhetin e shtetit të planifikuar për secilin vit në çdo ekonomi duke qenë se përmirësimi i kushteve rrugore ndikon në një zhvillim më të shpejt ekonomik nëpërmjet rritjeve të shkëmbimeve tregtare, zhvillimit të turizmit, dhe transportimit më të mirë të pasagjerëve nga një destinacion në një tjetër. Bazuar në analizën e kryer mbi “Modifikimin e infrastrukturës rrugore për rritjen e sigurisë në rrugë në Uganda”, nga grafiku dhe nga përlogaritja e koeficientit të korrelacionit Pearson me të dhënat e

aksidenteve rrugore, ashtu si dhe investimet infrastrukturore, vihet re një korrelacion negative midis dy treguesve me vlerë $-0,1$.

Kur investimet infrastrukturore pësojnë rënie, vihet re një rritje në numrin e aksidenteve në krahasim me vitin e mëparshëm ose e kundërta. Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës ka ndikuar dhe tek numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore duke u ulur vit pas viti. Duke qenë se një faktor i rëndësishëm është trafiku rrugor, këtu është marrë numri i mjeteve rrugore si tregues në ndërthurje me aksidentet rrugore. Vihet re që pavarësisht se numri i mjeteve rrugore përgjatë viteve 2011-2018 është në rritje, numri i aksidenteve rrugore për 1.000 mjete rrugore është në rënie. Ky tregues është një indikator i rëndësishëm i cili tregon se me përmirësimin e kushteve të infrastrukturës, është e mundur përballimi i më shumë mjeteve rrugore për kryerjen e transportimit të mallrave dhe pasagjerëve, si dhe një reduktimin e numrit të aksidenteve me pasoja. Pavarësisht marrëdhënies së variablave, fortësia midis tyre nuk paraqitet shumë e forte, me vlerën $-0,1$, çfarë tregon që ndikimi i rritjes së investimeve infrastrukturore nuk është shumë e fortë në numrin e aksidenteve për shkak se ndikohet nga faktorë të tjerë të përmendur. Efekti i investimeve në sigurinë rrugore si pasojë e ndikimit nga shumë faktorë si mjedisor, ashtu si edhe faktorët e sjelljes së drejtuesve të mjeteve apo kalimtarëve, bëjnë që investimet e reja apo përmirësimi i infrastrukturës aktuale të mos ketë një ndikim shumë të madh në reduktimin e numrit të aksidenteve me të lënduar, pavarësisht vlerës në ulje të numrit të aksidenteve vjetor dhe aksidenteve si pasojë e kushteve jopremtuese të rrugës.

REFERENCA

- [1] Cena, L., Keren, N dhe Li, W. (2007), "A full Bayesian Assessment of the effects of Highway Bypass on Crashes and Crash rates", Mid-Continent Transportation Research Symposium, Iowa, fq 8-14.
- [2] DeAngelo, G., Hansen, B. (2014), "Life and death in the fast lane: Police enforcement and traffic fatalities", American Economic Journal, Economic Policy, 6, fq 231-257.
- [3] Friday, D. (2012). "Modification of Road Infrastructure to Increase Driver Compliance in Uganda.", International Journal of Advances in Management and Economics. 1. 3-78. 10.31270/ijame/01/03/2012/10.
- [4] Fridstrom, L., Ingebrigsten, S. (1991), "An Aggregate Accident Model Based on Pooled, Regional Time Series Data, Accident Analysis and Prevention", 23: fq 363-378.
- [5] Gonzalez, M., Diaz, J. Francisco. (2015), "Effect on road safety of motorway infrastructure: Evidence from a natural experiment in Spain", fq 15-19.
- [6] Karlaftis, M., Tarko, A. P. (1998), "Heterogeneity consideration in accident modeling. Accident analysis and Prevention", 30, fq 425-433.
- [7] Milton, J., Mannering, F. (1998), "The relationship among highway geometric, traffic-related elements and motor vehicle accident frequencies." Transportation 25, fq 395-413
- [8] OECD (2019), "Data from ITF/Eurostat/UNECE questionnaires: Common Questionnaire".
- [9] OECD (2019), "Transport Safety: Road injury accidents".
- [10] Osun, J., Michell, R., Mackay, D., Humphreys, D., dhe Ogilvie, D. (2016), "Effects of new urban motorway infrastructure on road traffic accidents in the local area: a retrospective longitudinal study in Scotland", Olsen JR, et al. J Epidemiol Community Health 2016; 70:1088-1095
DOI: 10.1136/jech-2016-207378
- [11] Wooldridge, Jeffrey. (2003), "Introductory Econometrics: A Modern Approach", fifth edition

